

RENDI I DITËS

Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 80, subjekti ankues: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Objekti i ankimit: Kundërshtimi i vendimit nr. 531, datë 18.05.2023 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetarë, Bashkia Rrogozhinë”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli BELE, Z. Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** BF (Z. F. Nuri, Z. I. Kaso) PS (Z. M. Legisi)
- **Të tjerë:** Kandidatët: PS (Z. E. Memolla) BF (Z. Sh. Hoxha)

Z. L. Braho: Përshëndetje! Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 80 me ankimes Koalicionin “Bashkë Fitojmë”. KAS pasi u tërhoq për vendim bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, mbështetur në nenin 21 shkronja “b” dhe 143, pika 1, shkronja “d” të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash vendosi:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore nr. 80, datë 23.05.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
- Ndryshimin e vendimit nr. 531, datë 18.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve, për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

datës 14 Maj 2023”, sipas tabelës përmbledhëse të miratuar me vendimin e ndërmjetëm të KAS-it, të datës 5.06.2023.

- Rrëzimin e kërkesës për mospërfshirje në tabelën përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë të rezultatit të zgjedhjeve për QV nr. 2224/01 EVP Rrogozhinë.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

- U shpall sot në datë 6.06.2023.

Seancën e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 175

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

6.06.2023
Ora 12.34

RENDI I DITËS

Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 81+86. Subjekti ankues: koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe Partia Lëvizja e Legalitetit.

Objekti i ankimit:

- Kundërshtim i vendimit nr. 536, datë 20.05.2023 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz”.


- Kërkesë për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në OV-në nr.1575, 1597/2, për Bashkinë Kamëz.

PJESËMARRJA:

- KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmaili, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- Staf i KQZ-së: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj Znj. D. Alimemeti
- Parti politike: BF (Z. F. Nuri) PS (Z. M. Legisi, Z. A. Skënderi)
- Të tjerë: Z. Arjan Hoxha, Kandidat i BF, KRIIK

Z. E. Lako: Mirë atëherë, riçelim sot seancën për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 81 dhe 86, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 536 datë 20.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë dhe për këshillin e Bashkisë së Kamzës, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, si dhe

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz. Të pranishëm në seancë janë trupa e plotë e KAS-it, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm. Për palën ankuese përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë” zoti Nuri.

Z. F. Nuri – Franci Nuri –prezent

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: –Arjan Hoxha – prezent (Kandidati)

Z. E. Lako: Faleminderit! Ndërsa për palen e interesuar Partia Socialiste

Z. A. Skënderi –Ani Skënder - Present (Avokat)

Z. M. Legisi – Maringlen Legisi prezent (Avokat)

Z. E . Lako: Faleminderit! Rikujtojmë që shqyrtimi i kërkesës ankimore pasi pala tjetër “Lëvizja e Legalitetit” e konsumoi atë kërkesë në seancë e kaluar dhe KAS-i rishqyrtoi qendrat e votimit, objekt ankimi, kështu që sot nuk i kemi prezent në seancë, ndërsa seancën e kaluar e pezulluam, pra në datën 1 qershor të 2023, në mënyrë që KAS-i të kishte kohë të njihej me provat e depozituara nga subjekti ankues dhe njëkohësisht ankuesi të pajisej me pamje filmike të qendrave të votimit të mbetura pa u dorëzuar nga KQZ në atë datë. Jeni pajisur me këto pamje që kishin mbetur akoma pa u dhënë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve?

Z. F. Nuri: Zoti Lako, zot relator, kemi sërish një problem shumë të theksuar me pjesën e vendosjes së kamerave në dispozicion për Bashkinë e Kamzës. Është një

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

problematikë që ne e ngritëm dhe herën e kaluar. Ju kujtoj se 2 seanca me parë nga sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve këtu në seancë publike u dha konfirmimi që të gjithë qendrat e votimit dhe kamerat e të gjithë qendrave të votimit na ishin vënë në dispozicion, gjë që nuk rezultoi e saktë, vetëm gjysma e qendrave të votimit ishin vënë në dispozicion. Herën e kaluar kandidati, zoti Hoxha, paraqiti këtu një listë me përshkrimin për çdo qendër votimi, nëse kamerat ishin vënë apo jo në dispozicion, nëse filmimi ishte i përdorshëm apo jo, nëse kamera kishte filmime apo jo, sepse ka pasur edhe qendra votimi pa filmime fare, ku ka qenë bosh, ose te papërdorshme videot, kjo do të thotë që këndi i filmimit ishte i ulët e shiheshin vetëm tavolinat dhe jo se çfarë ndodhte mbrapa. Mbas kësaj e risjell në vëmendje që u la detyrë sërish që të na vihej në dispozicion për pjesën e mbetur të kamerave për ato qendra të votimit që ne i identifikuam dhe konstatojmë se ka përsëri problematika dhe jo problematike të theksuara me kamerat e vëna në dispozicion dhe kjo kur përsëritet 2 herë 3 herë, i bie që ka një problem serioz. Tani ose KQZ-ja nuk do që t'i vërë kamerat në dispozicion ose ka diçka për të fshehur, këtë ne nuk e dimë dhe nuk mund të aludojmë, por problematika është e tillë që kur vjen 3 herë i përsëritur dhe kamerat nuk janë në dispozicion ose nuk janë të plota, ose filmimet janë gjysmake. Një qendër votimi ka 12-13 orë filmime, të marrim vetëm disa minuta po disa orë filmime ajo qendër dhe mungojnë filmimet e tjera, kjo është skandaloze. Kështu që ne i rezervojmë vetes të drejtën për të paraqitur kallëzim penal në prokurori dhe në SPAK nëse do të jetë nevoja për të gjitha këto veprime. Le ta mbajë përgjegjësinë ai që e ka, KQZ -ja apo nënkontraktorët përgjegjës për kamerat, po këtu është një problem serioz, sepse po tentohen të fshihen provat, në gjykimin tonë.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Atëherë mund të shtoj 2 gjëra meqenëse unë kam asistuar në pjesën ku janë këqyrë, megjithëse janë vënë në dispozicion vetëm, afërsisht 24 orë përpara kësaj seance, pra me shumë vonësë, edhe në momentin që

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

janë vënë në dispozicion, janë vënë në dispozicion gjithsej 58 pamje filmike të qëndrave të votimit. Në shumicën e tyre jepen pamje filmike, në shumicën dërrmuese, të ndërprera, pra në qoftë se ka 12 orë filmim jepen 3 ose 4 orë filmim dhe në pjesën ku nuk ka fluks të madh të votuesve, kur është edhe probabiliteti dhe shkeljet më të mëdha. Edhe në këto pjesë që kanë dhënë në 4 qendra që ne arritën të shikojmë, të hapim, në 4 qendra votimi janë mbi 100 shkelje dhe pse këtu ka ndërhyrë dhe në disa prej tyre ka vetëm 20% të pamjeve nga totali. Në rast se ka funksionuar kamera dhe funksionon 20 minuta paradite dhe 20 minuta në dreke dhe 20 minuta pasdite, ajo kamera o ka funksionuar, o nuk ka funksionuar gjithë ditën. Pra unë dyshoj që kjo është absolutisht e qëllimshme, vënia e mënyrës sporadike e copëzave të filmimeve të qëndrave të votimit dhe selektimi i tyre heqja nga ato, të pamjeve filmike të cilat absolutisht faktojnë ndërhyrjen e qëllimshme, veprat penale që janë konsumuar, siç e kemi theksuar nga seanca e parë gjatë gjithë ditës në qendrat e votimit. Si është e mundur që vetëm 2 qendra, votimi që operatorët kanë qenë dhe i përgëzoj, që kanë mbajtur në 14-7,6 kurse tjetra nuk më kujtohet numri i saj, kanë mbajtur qëndrim vërtet korrekt, kanë zbatuar përgjegjësitë dhe detyrimet që parashikon Kodi Zgjedhor, ato janë të plota, ndërsa të gjithë të tjerat janë me ndërhyrje, janë me ndërprerje dhe të gjitha këto absolutisht që janë të qëllimshme, sepse probabiliteti për të qenë rastësore është zero. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Hoxha! Zoti sekretar i Përgjithshëm, keni ndonjë koment ose në lidhje me pretendimet e palës ankuese, janë vënë në dispozicion pamjet, janë të plota, ka ndonjë mangësi, cilat janë problematikat, në mënyrë që të sqarohen?

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. Y. Merkaj: Unë informohem nga drejtoresha e IT-së që kamerat janë vënë të gjitha në dispozicion të palës ankuese. Mund t'i them palës ankuese se pala ankuese ka pasur në çdo komision qendrës së votimit një anëtar, i cili nuk ka lënë asnjë shënim ka punuar apo s'ka punuar kamera. Përgjegjësia për vendosjen e kamerave është e operatorit të qendra e votimit, i cili është trajnuar për ta vendosur kamerën e mos ta lëvizur. Plus unë mund të them që të gjitha filmimet janë në kartat e memories, kamerat janë të implementuara dhe nuk mund të lexohen, nuk ka mundësi të ndërpriten. Çfarë kanë kërkuar jua kemi dhënë, të gjitha filmimet. Në qendrën e votimit pastaj janë anëtarët e përfaqësuesit të ankuesit, të cilët duhet të kishin bërë më shumë kujdes, duhet të kishin lënë shënime të libri i protokollit. Operatori e hoqi kamerën, lëvizi këndin e vrojtimit nuk e di çfarë të kishin lënë shënim, por nuk kanë lënë asnjë shënim. Në këto kushte mendoj që është tymnajë, nuk ka asnjë.

Z. E. Lako: Keni ndonjë rast konkret, zoti Nuri, zoti Hoxha, për filmimet që ju janë vënë në dispozicion, dhe sipas jush nuk lexohen, apo nuk janë të plota po janë me pjesë?

Z. F. Nuri: Zoti relator, ne e relatuam herën e parë, pra i shpjeguam herën e parë qendrat e votimit dhe unë i kam listuar një më një, po kandidati mund t'i bëjë përsëri, pra dhe qendrat me probleme dhe çfarë problemesh kanë patur.

Z. E. Lako: Jo, po flas për këto, ato herën e parë i keni marrë, i kemi parë, po flas për këto të tjerat që janë vënë në dispozicion, diçka konkrete që mos të flasim në përgjithësi.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Të gjitha këto konkrete, unë i kam bërë me shkrim dhe të rregullta apo me pamje deri diku të plota rezultojnë rreth 20% e qendrave të votimit, 80% e tyre ose nuk hapen, ose pamjet janë të cingura ose nuk ka pamje të qartë, pra nuk është rezonanca e duhur për të përcaktuar nëse ka patur apo jo shkelje nga komisionerët, operatorët apo persona të tjerë të paautorizuar në qendrat e votimit. Për të gjitha këto unë një kopje po ia dorëzoj administratës, që të mbajë qëndrimet. Po ashtu kam si provë edhe hardiskun e jashtëm, na është dorëzuar nga ana e KQZ-së, e protokollit, në të cilat përcaktohen saktësisht qendrat e votimit dhe ju mund ta përdorni si provë në rast se ato përftojnë apo jo pamje, apo në rast se këto që unë kam cituar këtu janë apo jo të vërteta. Faleminderit!

Z. E. Lako: Seancën e kaluar ne e mbyllim hetimin administrativ dhe thamë që nëse ju në bazë të provave të reja, pamjeve filmike, që keni marrë, do të keni kërkesë për ta riçelur, nëse keni pretendime të tjera, jemi të gatshëm që ta riçelim.


Z. F. Nuri: Po. Po kemi prova të reja sikundër janë...

Z. E. Lako: Atëherë bëni kërkesë që ta riçelim.

Z. F. Nuri: Patjetër, i nderuar relator, kemi prova nga këqyrja e kamerave dhe kemi përftuar fotografi dhe i kemi bërë me legjendë, pra t'i shpjegojmë se çfarë nënkupton secila shkelje, e pretenduar nga ne. Po jua vë në dispozicion që t'i ketë dhe trupa.

Z. E. Lako: Mirë, faleminderit! Do t'i relatoni shkurtimisht ato rastet tipike që ju pretendoni që ka shkelje të...

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

6 

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Atëherë për ekonomi kohe, unë nuk po kaloj në përsëritjen e atyre, se i thamë në vija të përgjithshme, në përqindje të saktë janë të depozituara dhe me shkrim dhe po kaloj direkt në pamjet filmike, të cilat ne për efekt kohe i kemi vetëm me foto dhe rezervojmë të drejtën, në një kohë sa më të shkurtër, t'i bëjmë, sepse po t'i paraqesim me pamje filmike janë të gjata. Pra, do t'i shkurtojmë dhe do t'i bashkojmë si herën e kaluar, do t'jua sjellim me pamje filmike çdo shkelje që është bërë në ato pak minuta që janë vënë në dispozicion nga kamerat. Atëherë më poshtë po ju demonstrojmë disa nga momentet e procesit të votimit, ku drejtorë të Bashkisë Kamëz kanë qëndruar në qendrën e votimit gjatë gjithë kohës të paautorizuar, kanë intimiduar dhe kanë nxjerrë të dhëna konfidenciale, të cilat duhet t'i administronte vetëm komisioni dhe operatorët. Rast konkret: Eni Bistri – drejtori i Tatimeve Bashkisë Kamëz qëndron gjatë gjithë kohës në qendrën e votimit duke ju bërë presion votuesve. Ja ku i kini me foto, është gjatë gjithë ditës aty me bllok në dorë, raporton më zë të lartë operatorja për personat konkretë që kanë marrë pjesë në votim dhe ky e delegon pastaj te pjesa tjetër duke marrë masa për ata që kanë çuar votën aty ku duhet apo ato që nuk kanë ardhur ende në votim. Këtu keni drejtoreshën e Ndihmës Ekonomike të Bashkisë Kamëz, Rajmonda Nikolli, përfaqësuese e PS-së në këtë zonë, votim kolektiv. Qendra e votimit 15-75-0, video 4, minuta 14.22 sekonda. Ja ku e kini me pamje. Më fal, vendosjani, sepse nuk i kini vënë pjesën e parë, është në pjesën e parë kjo që po relatoj.

Vazhdojmë tjetër. Ka disa dhe janë me shumicë, përsëri drejtoresha e Ndihmës Ekonomike, Rajmonda Nikolla, së bashku me familjarin e saj, po ashtu i paautorizuar, vëzhguesja tjetër e Partisë Socialiste, Flora Bistri, që mban shënim emrin dhe mbiemrin e çdo votuesi, pasi e lexon me zë të lartë nga komisionerja e PS-së që është afër operatorit të PEI-t në qendrën e votimit dhe ia transmeton drejtoreshës së Ndihmës Ekonomike. Video 11 minuta 4.54 sekonda, ja ku e kini me

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

7 

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

foto. Mësuese e shkollës profesionale “Peme Ndreu” duke shoqëruar dhe kontaktuar çdo votues në qendrën e votimit 15-75, se ja me foto e keni. Gjatë gjithë ditës kanë kryer këto veprime të gjitha këta punonjës të administratës publike vendore dhe mësues aktivistë të Partisë Socialiste kanë ndërhyrë tek çdo votues. Personi i paautorizuar që është në pamjen tjetër, i rrethuar nga ana ime, gjatë gjithë ditës ka qenë prezent në qendrën e votimit, nuk ka asnjë funksion në qendrën e votimit përveçse është i afërm familjar i drejtoreshës së Ndihmës Ekonomike. Ka kontaktuar çdo votues brenda qendrës së votimit gjatë gjithë ditës. Kjo është vetëm një qendër, jua sqaroj, sepse në qendra të tjera është e njëjta situatë, në çdo qendër me ato pamje që ne kemi arritur të fokusojmë dhe po të vazhdojmë në mënyrë të tillë, janë mbi 100 e ca raste vetëm në një qendër, më falni, 4 qendrat e votimit, dhe kjo është një kohë e reduktuar që ne kemi parë. Këtu keni pastaj të gjitha pamjet e tjera, që janë të fiksuara dhe ju i keni aty përpara, për shembull, qendra e votimit 15-89 voton operatori në mënyrë të hapur. Si kjo i keni të gjitha këto nga pas, por me video duken edhe më e qartë. Në qendrën e votimit 15-49 operatori ndërhyrë gjatë gjithë kohës në procesin e votimit. Unë jam përpjekur që të selektoj disa prej tyre si, për shembull, në 15-75, drejtoresha e Ndihmës Ekonomike, që ju thashë, jua legjendova me minuta, vëzhguesja e Partisë Socialiste, i keni në mënyrë të përmbledhur pastaj kronologjike, 18 nga ato më specifiket, që unë i kam listuar dhe problematikat në përgjithësi kanë qenë të tilla. Kemi votime kolektive. Votuesi shoqërohet pa procesverbal. Kjo ka qenë masive gjatë gjithë ditës dhe operatori, gjithashtu, i shoqëron. Votim me shoqërues pa procesverbal me shumicë. Kemi vëzhgues që mbajnë shënime emrat e votuesve, qendrat e votimit dhe punonjësja të tillë të administratës publike, që unë disa prej tyre i lexova më lart, ka dhe të tjerë në materialin e dorëzuar, pastaj jua japin personave të tjerë, po ashtu eksponentë të Partisë Socialiste jashtë qendrave të votimit, në mënyrë që të kontaktojnë, të

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

intimidojnë dhe të kontrollojnë çdo votues dhe votën e tij. Punonjës, drejtorë drejtorish të Bashkisë Kamëz, që monitorojnë të gjithë administratën e qendrave të votimit dhe punonjës të administratës publike që marrin pjesë në votim. Operatori qëndron para monitorit në shkelje të hapur e flagrante me përcaktimin që ka Kodi Zgjedhor duke kryer vetë veprime gjatë gjithë kohës. Operatori qëndron pranë votuesit para monitorit gjatë kohës që ai voton dhe po ashtu nuk mban distancën e përcaktuar. Këto dhe shkelje të tjera, të cilat ne i kemi bërë me shkrim, në rast se do na vijnë në dispozicion pamjet e plota, që unë jam i bindur që ekzistojnë në serverin kryesor ose një person i autorizuar i autorizuar nga ana juaj mund të shkojë t'i tërheqë vetë pamjet filmike në serverin kryesor.

Z. E. Lako: Mirë, nëse për momentin nuk kemi ndonjë gjë tjetër për të shtuar, pala interesuar ka ndonjë koment ose ndonjë prapësim në lidhje me çfarë u tha?

Z. M. Legisi: Jo, nuk kemi, thjesht për procedurë do të donim të kishim një kopje të provave dhe qëndrimin tonë mbi atë prova, vlerësoj se është i mjaftueshëm ta paraqesë në diskutimin përfundimtar. Faleminderit!

Z. E. Lako: Mirë faleminderit! Atëherë nga anëtarët e KAS-it, zoti Bele ka pyetje. Po zoti Bele.

Z. K. Bele: Më fal, nga çfarë na relatuat deri tani, sa qendra votimi ishin këto që janë të këqyrura që ju i keni marrë pamje?

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: 4 qendra votimi, por ju sqaroj që nuk është, nuk janë 12 orë të plotë të qendrës së votimit, në asnjërën prej tyre, janë minutazh në bazë të përcaktimit të kohës që na është vënë në dispozicion.

Z. K. Bele: Po, po, më fal thjesht dua të kuptoj dinamikën. Me sa shoh unë, të paktën në kuptueshmërinë time, këto kanë rezulucion të qartë dhe të lartë ose duket pastër, aq sa mund të japi kjo. Tani ju keni parë vetëm këto të katra, sikur keni parë edhe disa të tjera, është e njëjta cilësi në të gjitha, apo ka diferencë?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Jo, nuk është e njëjta cilësi përveç se cilësisë, sepse unë tek ajo në krah e kam legjenduar, ka pamje të paqarta, ka pamje ku fokusi i kamerës fokuson vetëm pjesën e pllakave të dyshemesë, apo këmbët e një pjesë e të komisionit, nuk fokuson qendrat e votimit dhe të gjithë pa pjesën e padukshme të monitorit, që është e përcaktuar sipas në vendosje. Ka po ashtu qendra votimi që na janë dërguar copëza të filmimeve apo që s'na është dërguar asnjë pamje nga qendra votimi konkrete.

Z. K. Bele: Po ju thatë që personi, shtetasi filan, përmendët nja 2 emra, kanë qenë në mënyrë sistematike gjatë gjithë ditës në qendrën e votimit, apo jo? Nga ana tjetër thoni që pamjet që keni marrë nuk janë të plota, janë pak orë.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Po, për ato pamje për ato 4 orë ka qenë gjatë gjithë kohës, pamje të tjera kur t'i kemi, se ne s'mund... Pra në ato 4 orë ka qenë në mënyrë sistematike, sepse maksimumi votimi i tij mund të zgjasë, në rastin më të madh 5 minuta, po themi me gjithë muhabetin që do të bëj.

*Zbardi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. K. Bele: Pra juve janë vënë në dispozicion vetëm këto 4 orë?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Vetëm 4 orë.

Z. K. Bele: Dhe në këto 4 orë, sipas jush provohet shkelja. Pra supozimi logjik është që pavarësisht se nuk e di sa e vërtetë është, e marrë të mirëqenë fjalën tuaj që ka punuar vetëm 4 orë, nuk ka ndërhyrje për të dhënë 4 orët që kush do ndonjë palë tjetër, po ju kanë dhënë ato 4 orë që funksionojnë. Pra nuk ka, po e quaj prerje qepje të filmimit, apo jo?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Jo, prerje të filmimit, sepse filmimi dorëzohet çdo 20 minuta, filmon, sepse e tillë është procedura e shkarkimit nga serveri kryesor dhe ato 20 minutëshat janë të plota, por ato 20 minutëshet nuk janë në mënyrë vazhduese nga ora 07:00 e mëngjesit deri në orën 19:00 që mbyllet qendra e votimit. Dhe aty nuk përcaktohet koha kur është ky 20 minutësh, apo 20 minutëshi tjetër. Pra, ne nuk jemi në gjendje ta përcaktojmë saktë se këto 4 orë që na janë dërguar janë paradite apo pasdite. Thjesht nga fluksi i vogël i votuesve ne pretendojmë që janë pasdite, sepse gjithmonë numri më i madh i votuesve është paradite.

Z. K. Bele: Pse nuk del ora aty?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Jo nuk del..

Z. K. Bele: Po, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. F. Nuri: Unë desha të bëj një plotësim për pyetjen e zotit Bele. Ne jemi të gatshëm që kamerat që na janë vënë në dispozicion nga KQZ-ja në atë gjendje që janë, t'jua vëmë dhe juve në dispozicion për efekt jo vetëm të transparencës por edhe ju të bëni *cross referencë* dhe t'i kontrolloni nëse këto që po themi ne dhe kandidati janë të sakta apo jo.

Z. E. Lako: Po, zoti Braho.

Z. L. Braho: Kisha pyetje për administratën për këto kamerat në qendrat e votimit. Operatori që ka përgjegjësinë për të montuar kamerën siç duhet është i njëjti që merret dhe me pajisjen PEI? Kush i trajnon këto?

Z. Y. Merkaj: Stafi i KQZ-së.

Z. L. Braho: Po përgjegjësinë kush e mban?

Z. Y. Merkaj: Përgjegjësia është individuale, së pari, sepse janë trajnuar të gjithë edhe me tutoriale janë trajnuar, iu kemi vëzhguar edhe videot për t'i parë si funksionon.

Z. L. Braho: A është e mundur për operatorin?

Z. Y. Merkaj: I është thënë që duhet ta vësh kamerën në orën 7 të mëngjesit dhe ta heqësh në orën 19 të darkës, kështu i kemi thënë.

Z. L. Braho: A është e mundur që për këtë pjesën e...

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. Y. Merkaj: Dhe kamera punon edhe pa qenë aty, sepse ka bateri.

Z. L. Braho: Të ndalemi te pjesa e fokusimit që janë disa kamera që kapin jo atë që duhet, pra nuk filmojnë atë që duhet të filmojnë. A është mundësia për operatorin që pa parë video live që të llogarisë...

Z. Y. Merkaj: Nuk e shikon dot, nuk ka një shikues që ku fokusohet kamera.

Z. L. Braho: Atëherë si janë trajnuar ata, me sy të lirë?

Z. Y. Merkaj: Kamera është vendosur në ambientet e KQZ-së para se të shkojë në ambientet e KZAZ-së. Tani nga transporti mund të ketë lëvizur kamera. Kjo është risku që marrim përsipër, nuk e merr dot personi për këtë përgjegjësinë. Thjesht ajo është me sy të lirë mund ta vendosesh kamerën në një pozicion që të ketë fshehtësinë e votës, kështu është bërë trajnimi.

Z. L. Braho: Po fshehtësinë e votës e kuptoj.

Z. Y. Merkaj: Pra, të ruajë fshehtësinë e votës dhe të shikojë ambientin përreth. Kaq. Ky është trajnimi që u kemi bërë dhe për këtë i kemi orientuar.

Z. E. Çefa: Kam dy pyetje. Pra, pretendimet e ngritura nga ankimuesi për mosvënien në dispozicion të të gjitha kamerave, a mund të na sqaroni pak më konkretisht? Ju thoni ia kemi vënë në dispozicion të gjitha, ata thonë se nuk kemi pjesën më të madhe tani, si është tamam?

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Znj. D. Alimemeti: Pamjet filmike që janë të të gjitha kamerave që janë kërkuar janë vënë në dispozicion. Unë kam kontaktuar personalisht me zotërinë dhe të gjithë QV-të që mungonin ia kemi dërguar kompanisë dhe kam marrë mbrapsht informacionin që kanë kamerat. I gjithë ky informacion i është kaluar dhe është punuar, në bazë të këtij informacioni është punuar. Përveç kësaj kemi thënë që nëse keni dyshime, çfarëdolloj dyshimi të keni, mund të vini dhe të shikoni vetë kamerat, procesin e punës, ambientin, mënyrën si ruhet, dhe si kalon ky informacion. Mund t'i vihet në dispozicion dhe të shikojnë që të mos kenë asnjë problematikë dhe asnjë dyshim, le të themi, në lidhje me procesin.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Tani ankuesi për këtë në këtë moment më qëndroni, a i keni marrë të gjitha dhe pjesa më e madhe janë të dëmtuara dhe nuk shihen? Pra, dua të di a ju është dhënë i gjithë materiali i mirë ose i keq, i shikueshëm apo i pashikueshëm? A ju është vënë në dispozicion apo jo?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Atëherë, që të jemi konkretë, aty kam legjenduar dhe kur dorëzohet një provë, të paktën minimumi i asaj të shkruhet që unë të dhashë qendrën e votimit 1,2,3,4 se e kanë pasur të lehtë, sepse unë e kam shkruar me numra qendrash votimi duke mos pasur asnjë infrastrukturë mbështetëse logjistike, siç mund ta ketë KQZ-ja dhe operatori i kamerave. Duhet të më kishim dhënë përgjigje që ne të dhamë kamerën 1, 2 deri te 133, gjithsesi unë ju kam kthyer përgjigje dhe ato që janë bosh janë të padorëzuara ende ato qendra votimi. Pra, ato që janë aty, dhe çdo aparaturë dhe *hard disk* i jashtëm është edhe sot që është në dispozicionin tonë mund t'jua vëmë në dijeni dhe nuk ka nga ato. Një pjesë e tyre janë të copëzuara, janë disa orë nga 12 orë filmim dhe nuk mund të ndodhë që ai ta fikë gjatë procesit të

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

asaj, ajo kamera ose ka funksionuar të gjithë ditën, ose nuk ka funksionuar fare, po marrim sikur nuk ka funksionuar. Po ashtu ne do t'ju sjellim provë që edhe anëtari i komisionit e lëviz me dorë në tij kamerën në lagjen Lura dhe e pozicion që të mos kapë veprimet në kutitë e votimit. Që nuk ka asnjë të drejtë të ndërhyjë në pamjet filmike. Do t'jua sjellim sërish me provë dhe me emër konkret, me rast konkret. Gjithsesi në respekt të pyetjes suaj, ju sqaroj: ka qendra votimi që nuk janë dorëzuar, ka qendra votimi me pamje të paqarta, me fokus lokal që nuk fokuson veprimet e komisionit dhe të cingura siç u shprehëm më lart dhe të pëdukshme, siç u shprehëm ose nuk duken qartë. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Historia e atyre që nuk duken qartë është diçka tjetër, ato që nuk janë vënë në dispozicion, sa qendra votimi janë, afërsisht plus minus në raport me të gjitha qendrat e votimit të ZAZ-së?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Për efekt kohe nuk e kam bërë një analizë të tillë, sepse i dorëzova të dy kopjet që kisha një ia dhashë palës së interesuar dhe një ia vendosa administratës.

Z. E. Çefa: 50%, 70%, 20%?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Po t'i marrim me përqindje se sa për qind e kamerave që ne nuk kemi arritur të...

Z. E. Çefa: Që ju pretendoni që nuk ju janë vënë në dispozicion, jo atij që nuk keni mundur t'i shihni.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Atëherë, po e thjeshtëzoj, po marr si shembull mbi 50% të tyre ne nuk kemi pamje filmike të qendrave të votimit, sepse nuk na janë vënë në dispozicion.

Z. E. Çefa: Sepse nuk janë vënë në dispozicion, apo sepse kamerat nuk kanë filmuar?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Një pjesë nuk na janë vënë në dispozicion, një pjesë nuk kanë filmuar dhe një pjesë tjetër janë me orë të cinguar, por që të jem korrekt janë mbi 50%. Është më tepër, por unë që të jem korrekt me ju po them mbi 50%.

Z. F. Nuri: A mund të jap një sqarim zoti Çefa? Në materialin në tabelë eksel që ju kemi vënë në dispozicion do ta keni shumë të qartë, është edhe me ngjyra për çdo qendër votimi nëse kamera ka qenë ok, apo kamera ka pasur problematikë dhe cilën problematikë ka pasur. Pra, keni të gjitha qendrat nga 1-133. Pra janë 133 qendra votimi për bashkinë Kamzës keni në kolonën tjetër numrin e qendrës së votimit përkatëse dhe të shkruar problematikën. Pra, ju mund ta shihni dhe me sy të lirë përqindjen aty për efekt provueshmërie. Këtë material tani nuk e disponojmë, sepse sapo jua vumë në dispozicion.

Z. E. Çefa: Tani edhe një pyetje tjetër, tipologjia e shkeljeve që ju pretendoni se keni konstatuar nga analizimi i pamjeve filmike të këtyre kamerave që keni pasur në dispozicion, janë kryesisht të ndërhyrjes së operatorit në votim, apo jo, të qëndrimit për një kohë të gjatë të personave të paautorizuar në qendrën e votimit që ju sigurisht e lidhni me faktin që mund të kenë shërbyer për të intimiduar ndoshta votuesit ose për të orientuar votimin dhe tipologjitë e tjera, pra ju lidhni faktin që kamerat nuk

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

kanë filmuar vazhdimisht ose që nuk kanë filmuar fare, ose që kanë filmuar në pozicione jo të duhura me një qëllim le të themi të caktuar për të mos pasqyruar atë që ndodh realisht në qendër votimi apo jo? A e kam kuptuar drejtë pra këtë doja të dija?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Kjo, sepse jemi fokusuar të gjithë seanca po zhvillohet rreth pamjeve filmike të qendrës së votimit, që është një nga kërkesat tona, sepse kërkesat kanë qenë disa dhe kjo është njëra prej kërkesave. Nuk është marrë ajo esenciale, nuk na është dhënë mundësia e takimit të ekspertit, që absolutisht kemi bindej të bazuar në dyshime të arsyeshme, që ka qenë algoritëm dhe paraprogramim i sistemit elektronik. Gjithsesi unë do t'i përgjigjem pyetjes suaj. Shkeljet me çfarë përftohet jo vetëm nga pamjet filmike po nga çdo veprim tjetër kanë qenë ndërhyrja e operatorit votimi i operatorit në një masë shumë të madhe deri në 80% në raste në disa qendra votimi.

Z. E. Çefa: Të rasteve që ju keni parë.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Po të rasteve që kemi arritur të këqyrim për këto pak orë. Dhe çfarë na është vënë në dispozicion. Nuk jemi thjesht qëndrimin e personave të paautorizuar, apo të personave të rastësishëm, kemi drejtorë të drejtorive kryesore të Bashkisë së Kamzës drejtor të tatimeve, drejtor të ndihmës ekonomike, drejtor të ujësjellës kanalizimeve e të tjera me radhë, të cilët nuk është se kanë një rol pasiv thjesht qëndrojnë në qendrat e votimit, ata janë me bllok në dorë, kontaktojnë rakordojnë veprimet me operatorin kontrollojnë çdo votues, pra është prekur themeli i procesit që është liria e votimit, që prevalon mendoj unë edhe mbi të drejtën administrative, që është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutë në ligjin themeltar

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

të këtij vendi. Dhe nuk janë shkelje të rastësishme, por kjo ka qenë e koordinuar në çdo qendër votimi. Dhe, nëse do të shikoni 100 emra që unë kam dorëzuar para jush unë kam specifikuar në çdo qendër votimi ka qenë e përcaktuar drejtorët dhe nëndrejtorët dhe përgjegjësit të caktuar me detyra konkrete. Në këto pak pamje filmike që janë vënë në dispozicion faktohet pretendimi që ne kemi ngritur që në fillim të këtij procesi, që këta kanë pasur një mision, misioni është dorëzimi i kontrolluar i çdo votuesi dhe kontrolli i këtij *feedback*-u pas dhënies së votës, çekimi tyre me bllok në dorë kush erdhi në votim kush mungoi, pse ka munguar dhe raportimi në mënyrë hierarkike duke kontrolluar çdo qelizë në datën 14, çdo votues që nga dalja e tij nga banesa deri në përcjelljen e tij në banesën e tij, duke kontrolluar që ky dhe të afërmit e tij kanë votuar, përveç se mungesës që duket hapur në disa qendra votimi që vota kontrollohet me sy të lirë se njëshi me treshin janë në distancë. Ajo fokusohet duke qenë punonjësi drejtoi i administratës në qendër votimi arrin që punonjësin e vet ta ketë nën monitorim me sy.

Z. E. Çefa: Tani shkurtimisht edhe diçka tjetër se nuk dua të zgjatem dhe t'i marr kohë kolegëve. Ju keni pasur besoj unë përfaqësues në qendrën e votimit gjatë procesit, këto problematika që janë lehtësisht të konceptueshme apo të prekshme në ato momente ai kanë sinjalizuar sipas procedurës këto parregullsi? Ai kanë sinjalizuar përfaqësuesit tuaj që keni pasur në qendër votimi?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Po mua më kanë sinjalizuar dhe po shikoj dhe daljen time për respekt të heshtjes zgjedhore me datën 14 unë kam heshtur nuk kam reagu. Pas datës 14 unë kam reagu publikisht që jam informuar nga vëzhguesit dhe nga komisionerët që në shumicën dërrmuese të qendrave të votimit ka pasur problematika të tilla prandaj dhe unë i kam paraprirë në materialin e parë që kam

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

vënë në dispozicion. Para se t'i shihja këto pamje unë nuk kisha si t'i dija tjetër përveç se një raportimi që kam marrë nga vëzhguesit dhe komisioneri, se një komisioner kemi pasur në disa prej qendrave të votimit, të cilat unë i kam vënë dhe me emra konkret që rakordojnë me emrat që sot dalin në pamje filmike.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Nuk kam pyetje të tjera.

Z. E. Lako: A ka pyetje të tjera nga kolegët? Pak a shumë pyetjet u ezauruan. Edhe unë kisha dy pyetje, por zoti Çefa konsumoi një pjesë të mirë të tyre, por do të ndalem pak te kjo pyetje e fundit, e cila kishte të bënte më shumë që këto raportime a janë evidentuar në dokumentacionin zgjedhor? Se pak a shumë tipologjia e shkeljeje ishin ato të konstatuara dhe seancën tjetër me pamje filmike të para, pra pretendimet për ndërhyrjen operatorit, për persona të paautorizuar që intimidonin sipas jush zgjedhësin në qendrat e votimit? Pra pak a shumë kjo është tipologjia, por këto lloj shkeljesh a janë evidentuar, bëhet fjalë për ditën e votimit, jo për para këtij procesi, sepse komisioni i qendrës së votimit vepron vetëm atë ditë, kur fillon dhe mbaron e gjithë veprimtaria e tij. Po flasim për këtë pjesë? Pra, a ka ndonjë provë në procesverbalet e mbledhjeve të komisionit të qendrës së votimit në lidhje me këtë tipologji shkeljesh?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Pyetja juaj nuk i cenon aspak provat që unë kam dorëzuar, sepse ato janë e pamje filmike dhe duket roli dhe veprimi i tyre pavarësisht nëse kjo evidentuar ose jo, sepse vëzhguesit siç e dini edhe ju më mirë se unë nuk ka asnjë mundësi përveç se të vëzhgojë dhe të na informojë, nuk ka mundësi të nënshkruajë në asnjë procesverbal, sepse thjesht vëzhgues janë ato, ndërsa në rast se unë vetë ju kam vënë në dijeni edhe në seancat e kaluara që jam bllokuar pikërisht

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

nga këta drejtorë të caktuar me mision të posaçëm që të mos kontaktoja asnjë nga komisionerët dhe të paktën t'i orientoja, meqenëse unë jam jurist me profesion dhe pak a shumë të përgjithshme janë ato detyra të përgjithshme se çfarë roli ka një anëtar komisioni, pra jam bllokuar konkretisht në qendrën e votimit që ju kam vënë në dispozicion prej ditës së parë ku ka mbi 70 raste flagrante të ndërhyrjes së votimit të operatorit nga drejtori Elvis Gjika. Jam bllokuar që unë të mos i kontaktoj as të mos i përshëndes se janë komisioner pavarësisht çfarë krahu politik mbanin, sepse ata kishin një mision atë ditë pavarësisht bindjeve të tyre personale. Dhe kjo ka qenë e rakorduar në veprimet e saj. Gjithsesi unë nuk jam në gjendje ta them se nuk e di si ka vepruar një komision apo një komision tjetër, nuk kam protokoll përpara se si i kanë mbajtur shënimet, por gjithsesi ato prova që ne ju vumë në dispozicion nuk ka rëndësi në rast se është përgjegjësi e një anëtari të komisionit të çfarëdolloj pale të jetë shkel ato vepra penale që janë zhvilluar para syve të tij dhe nuk kanë mbajtur qëndrimin e duhur, atëherë është përgjegjësi e gjithsecilit individualisht, siç u tha dhe më parë këtu sepse e kemi elauburuar këtë tezën e përgjegjesisë individuale, kështu që do t'i rrimë deri në fund përgjegjesisë personale. Faleminderit!

Z. F. Nuri: Një plotësim nëse mundem zoti relator, e shohim shpeshherë që bëhet pyetja: nëse janë mbajtur shënim në procesverbal apo jo ankimet tona. Së pari, duhet ta ritheksojmë edhe njëherë se ndoshta nuk e ka kuptuar mirë edhe publiku dhe qytetarët, ne nuk kemi pasur komisionerë në të gjitha qendrat e votimit si koalicion Bashkë Fitojmë, kemi pasur në gjysmën e qendrave të votimit në të gjithë Shqipërinë. E para, e dyta, edhe sikur t'i kishim vëzhguesit dhe komisionerët në të gjitha qendrat e votimit fakti se kanë shënuar apo jo në procesverbalet nuk e bën ose nuk e anulon, ose nuk e bën të pavlefshëm ankimin tonë, këtu dhe argumentet që ne ngremë këtu para KAS-it nuk i humbet vlera në gjykimin tim nëse në një qendër

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

votimi, apo në një qendër tjetër votimi në procesverbal nuk ka ndonjë gjë apo nuk figuron ndonjë ankesë e posaçme, sepse përndryshe Kodi Zgjedhor do ta kishte parashikuar me domosdoshmëri që për të ngritur një argument në KAS duhet që paraprakisht të jetë shënuar në librin e protokollit. Unë nuk di që Kodi Zgjedhor të ketë një dispozitë të tillë. Nëse ka ju lutem ma sqaroni, si funksionon, por në dijeninë time nuk ka një kusht të tillë që të bëjmë njëherë fillimisht ankimin në qendrën e votimit dhe pastaj të na lindë e drejta të ankohe mi në KAS. Fakti se në librin e protokollit ka ose nuk ka diçka ne nuk na pengon aspak që të ngremë këtë argument këtu përpara jush.

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Nuri! Ne patjetër që e kemi marrë në shqyrtim ankimin tuaj dhe nuk e kemi kondicionuar me problemet që mund të ketë pasur për këtë procesi në qendrën e votimit, por pyetjet kanë të bëjnë me faktin që këto pretendime ku mbështeten dhe ju deri tani keni mbështetjen vetëm të provave filmike dhe ne na lejohe t që të pyesim që këto pretendime a janë të mbështetura dhe në atë çfarë konstatuar komisionerët gjatë ditës së votimit. Ne nuk po pretendojmë që ju nuk legjitimoheni, sepse ju kemi legjitimuar në seancën paraprake, këtu jemi ën shqyrtimin e provave kështu që po flasim për provat që keni paraqitur dh që ne i kemi shqyrtuar dhe po shqyrtojmë dh hetojmë në lidhje me to. Po, zoti Çefa.

Z. E. Çefa: Ju kërkoi ndjesë edhe një pyetje, dhe do t'jua shpjegoj pse po ju bëj pyetjen. Ju i keni identifikuar kush janë personat që ju pretendoni që kanë pra operatorët që ju pretendoni se aknë votuar për të tjerët, pra me emër dhe mbiemër i keni? Nuk ka mbaruar pyetja por po, a i keni identifikuar?

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

21


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*


Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Ne ju dorëzuam dy operatorë dhe një anëtar komisioni, por ajo është lehtësisht e verifikueshme, sepse atë ditë aknë pasur një listë dhe secili operator ka një qendër votimi.

Z. E. Çefa: Sigurisht që është e identifikueshme dhe ky nuk përbën aspak problem. Pse pyeta unë? Unë pyeta sepse doja të dija nëse ju në investigimin tuaj keni shkuar përtej, pra mos ndoshta ka një lidhje ndërmjet këtyre personave dhe ndonjë partie politike? Prandaj pyetja ime ishte a i keni identifikuar, dhe a keni gjetur lidhje me ndonjë subjekt tjetër për të bërë po themi atë lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit që ju pretendoni që ato aknë kryer dhe qëllimit për të cilin ato e kanë kryer këtë veprim? Pra për këtë arsye e bëra pyetjen.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Faleminderit për pyetjen tuaj. Absolutisht që e kemi bërë në atë kohë që kemi pasur dhe mundësi që janë absolutisht të reduktuara dhe e kemi faktuar dhe ju kemi vendosur në seancën e kaluar ku operatori është edhe njëkohësisht një mbështetës i hapur edhe në rrjetet sociale publike i kandidatit Rakip Suli, kemi printuar një fletë dhe jua kemi vënë në dispozicion. Po ashtu komisionerja është përgjegjëse në e bashkisë Kamzë të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a dhe absolutisht kanë lidhje të drejtpërdrejtë pune dhe kanë lidhje dhe janë eksponentë të njohur në zonë të Partisë Socialiste dhe të kandidatit Rakip Suli. Faleminderit!

Z. E. Lako: Vetëm një gjë se mbase e kuptova unë gabim kur thatë që keni pasur komisionerë vetëm në gjysmat e qendrave të votimit, a ka ndonjë gjë të veçantë në Kamzë, sepse në kuptueshmërinë time në çdo qendër ka komisionerë, apo mos i referoheni grupeve të numërimit, nuk keni numërues.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

22 

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Më falni avokati e shprehu në gjysmën e komisioneve në të gjithë Shqipërinë. Në Kamzë ka qenë një anëtar i komisionit i Partisë së Lirisë, që absolutisht meqë ishim në komision kemi rakorduar në vendosjen e këtyre emrave edhe pse nuk ka qenë i Partisë Demokratike, i yni, mund të ketë qenë kështu e kemi pasur një anëtar komisioni dhe 2 vëzhgues në çdo qendër votimi.

Z. E. Lako: Po, drejtoresha për administratën.

Znj. D. Alimemeti: Kandidati specifikoi një frazë që thotë “Operatori voton”. Dua të sjell në vëmendje një element të procedurës së miratuar për votimin elektronik. Në rast se një nga votuesit qëndron më shumë se sa 5 minuta përpara makinës, atëherë është detyrë e operatorit, pajisja bllokohet le të themi, dhe është detyrë e operatorit që me anë të kodit pin dhe të kartës ta risjellë pajisjen në funksion dhe të jetë e vlefshme për të kaluar në votimin e radhës. Edhe një element tjetër, që dikush të votojë, duhet të aktivizohet votimi me butonin e aktivizimit nga anëtarët e komisionit, kryetari ose kush është i caktuar për këtë. Kjo është thjesht për t’u sjellë në vëmendje që operatori voton, jo gjithmonë shkon me situatën që duket në video.

Z. E. Lako: E qartë, se edhe në seancën e kaluar u demonstrua një përdorim i pajisjes ku u votua edhe në mënyrë të përsëritur shumë herë nga të pranishmit, kështu që pa a shumë është i kuptueshëm procesi. Zoti Hoxha edhe një herë.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Kjo nuk çmon dhe nuk hedh poshtë asnjë prej provave që unë ju kam vënë në dispozicion. Unë e kam parë me vëmendje dhe ju kam vënë në dispozicion edhe herën e kaluar që për dy tre raste sporadike unë nuk ju kam vënë në lëvizje fare. Unë kam vënë në dispozicion dhe nuk ka asnjë nga ato pamjet

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

23


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

filmike, e sfidoj, që të ketë qëndruar një votues 5 minuta, atë nuk e ka lejuar të qëndrojë as 20 sekonda i paasistuar, jo më 5 minuta, dhe në këtë rast duket kur operatori merr masa për zhbllokimin e procesit, sepse ka veprime të tjera, ka rakordim dhe në dijeninë time duhet vënë në dispozicion, edhe komisioni mban një shënim që në filan minutë u ndërpre, sepse qëndroi më tepër dhe operatori ndërhyri për këtë rast, evidentohet nga libri i protokollit. Në rast se më vini në dispozicion një libër protokollit, atëherë po. Në pamjet filmike duken qartë, unë kam shkuar tek ato sekuenca, t'i shohin ato sekuenca e t'i hedhim poshtë pretendimet e mia. Faleminderit!

Z. E. Lako: Nuk prapësoi, me sa kuptova unë, bëri një sqarim për funksionin e operatorit dhe çfarë funksionesh ka atë ditë. Nuk është se prapësoi pamjet filmike.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Edhe tjetra, butoni, në dijeninë time, qëndron te komisioni dhe jo afër pajisjes së monitorit. Kështu që ajo bie poshtë që operatori të afrohet atje, aktivizon, por nuk është aty përpara monitorit. Ma sqaro, se ndoshta unë nuk e di mirë.

Z. Y. Merkaç: ...që bën komisioni i qendrës së votimit, sepse ka butonin atje, por nuk e shtypi anëtari i komisionit, nuk e lejon zgjedhësin të votojë.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Nuk ka lidhje me operatorin me provat që kam paraqitur.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

24


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. E. Lako: Të mos e bëjmë debat, se provat i KAS, jo administrata. Mirë, nëse nuk ka pyetje të tjera nga anëtarët e KAS-it, pala ankuese ka ndonjë pretendim ose shpjegim, apo ta quajmë të mbyllur?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Pretendimet e mia janë të tilla: asnjë nga kërkesat që ne kemi kërkuar nuk janë plotësuar deri tani. Kërkesat kryesore janë gjithsej 9 kërkesa minimalisht. E para, nuk na është sqaruar akoma dhe nuk na është krijuar mundësia e caktimit të një eksperti të pavarur, i cili do të bënte këqyrjen e trurit, po e thjeshtëzoj, të çdo pajisje me të cilën është votuar dhe është prodhuar një rezultat makinerie dhe jo rezultat votuesi në datën 14 maj. Pra nga të gjitha këto kërkesa, nuk është shteruar asnjë prej tyre. Unë nuk e di sesi do dalin me pretendime përfundimtare nga ana jonë, ndërkohë që asnjë nga kërkesat që kemi vënë në lëvizje dhe është pranuar nga ana juaj, jemi legjitimuar si palë, ne do dalim në pretendime përfundimtare. Kjo është e pamundur objektivisht dhe nga ana juridike unë besoj që asnjë nuk mund të dalë në një konkluzion përfundimtar, aq më pak nga ana jonë kur nuk janë plotësuar asnjë dhe nuk kemi një pamje të qartë me ato mundësi që ne kemi sot që të bindim këtë komision që ai rezultat ka qenë i parafabrikuar dhe jo rezultat i votave të qytetarëve në Bashkinë e Kamzës. Faleminderit!

Z. E. Lako: Zoti Hoxha, ne i kemi shqyrtuar dhe i kemi pranuar të gjitha kërkesat tuaja në lidhje me hetimin administrativ. Kërkesa që ju sapo bëtë, se “të gjitha” është një fjalë e përgjithshme. Ne, në dijeninë time, i kemi shqyrtuar dhe pranuar. Kërkesa që sapo thatë në lidhje me një ekspert për të verifikuar ligjshmërinë e makinerive, ta themi kështu, është një kërkesë që nuk i përket një procedimi administrativ, sepse pretendimet tuaja për falsifikim, se ky është një lloj falsifikimi, që të votosh për tjetrin e të dalë kandidat tjetër. Pretendimet për falsifikim i përkasin një procesi

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

penal, jo një procesi administrativ. Në procesin administrativ kemi disa pajisje, të cilat janë të certifikuara, janë sipas ligjit, është bërë prova, ju jeni ftuar që t'i verifikoni, është bërë edhe verifikimi sipas ligjit i fletëve fizike në kuti me atë çfarë është votuar në trurin kompjuterik, ashtu siç e relatuat ju, ndërsa pretendimet që njerëzit, votuesit kanë shtypur tjetër e ka dalë tjetër, janë pretendime të pabaza dhe i përkasin një procesi penal, mendoj unë, jo administrativ. Nëse ka pretendime për makinerinë që falsifikon votën, është një falsifikim i votës dhe nuk e di në këtë fazë a mundet të shqyrtojmë pretendime të tilla. Nëse ju vazhdoni e i qëndroni kësaj, mund ta bëni këtë kërkesë dhe KAS-i mund të tërhiqet të marrë një vendim në lidhje me këtë.

Z. F. Nuri: Për sqarim, kandidati i referohet kërkesës që ne kemi depozituar në datën 25 maj, njëlloj si për Elbasanin, ku dje u tha që duhet të na jepej me shkrim përgjigjja. Kërkesa e parë ishte vënia në dispozicion e kamerave, kërkesa e dytë është arkitektura e sistemit, çfarë hapash janë marrë për sigurinë, pra janë në formë pyetjesh teknike. Minimumi ne prisnim një përgjigje me shkrim lidhur me këto, autoidentifikimi, autorizimi, hapja e kodit etj., etj., këtu e kemi më tepër atë merakun në aspektin administrativ, i nderuar relator, pra, as përgjigje zyrtare nuk kemi marrë për këto, sikundër edhe pika e parë, kamerat, nuk janë vënë në dispozicion të plota, pra, këtu është më tepër çështja, besoj këtu e kishte fjalën edhe kandidati.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Në qoftë se nuk e kam shkruar drejt këqyrjen nga një ekspert i pavarur, atëherë po them auditim nga një ekspert i pavarur në qoftë se këqyrja është, me të drejtë është konstatimi juaj, veprim procedural, që absolutisht kur ka një vepër penale, bëhet këqyrje. Në rastin konkret po e korrigjoj dhe po them auditim nga një ekspert i pavarur, që, përveçse sjell një besueshmëri ky proces i

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

25


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

votimit elektronik në vitin 2025 e në vijim mund të zbatohet, meqenëse është projekt-pilot, jo vetëm në Kamzë, në Vorë e Elbasan, por në të gjithë Shqipërinë, atëherë një auditim nga një ekspert i pavarur dhe kërkesa tjetra, edhe pse akoma nga KAS-i, drejtoresha e IT-së ju është kërkuar në seancën e kaluar që të na vihet në dispozicion dokumentacioni i saj, certifikata e sigurisë, cila firmë i projekton, nëse dikujt i duket e tepërt ose është kërkesë joserioze, edhe mund ta kundërshtojë, dhe cila firmë e ka magazinuar, e ka ruajtur, cila e ka testuar dhe e ka vënë në funksion. A janë respektuar elementet e sigurisë dhe transparencës?

Z. E. Lako: Zoti Merkaj, ju lutem, edhe një herë, se unë e di që është thënë në një proces ankimi tjetër, por, meqenëse pretendohet që nuk kanë marrë përgjigje në lidhje me këtë, pse nuk është dhënë përgjigja, dhe një përgjigje brenda mundësive çfarë u pretendua tani nga ankuesi.

Z. Y. Merkaj: Ne ankuesit vetëm t'i japim certifikatat ISO, njëra është për siguri, tjetra për menaxhimin e procesit, madje mund t'ia vëmë edhe në dispozicion. Kompania që ka bërë programimin është kompani ndërkombëtare, është shumë e njohur, e cila i ka programuar vetë këto dhe janë magazinuar nga kompania në magazinat e KQZ-së, pra janë shpërndarë në qendrat e votimit nga KQZ-ja. Nuk ka pasur asnjë kontraktues tjetër...

(Diskutime pa mikrofon.)

I ka sjellë në aeroport dhe nga aeroporti i kemi marrë ne.

(Diskutime pa mikrofon.)

Në lidhje me kërkesat me shkrim që ka bërë pala ankuese, i kemi përkthyer në anglisht, ia kemi dërguar kompanisë. Presim përgjigje. Nesër do të kthejë përgjigje. Ka kërkuar kohë që të kthejë përgjigje. Ky është imeili që na kanë sjellë.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. E. Lako: Po, zoti Braho.

Z. L. Braho: Kisha një pyetje në lidhje me këtë kërkesën që bën pala ankimuese për ekspertim kompjuterik të çdo pajisje që të bëhet me ekspert të huaj. A është e mundur që, nëse caktohet një ekspert pa pasur këtë kodin e *software*-it dhe arkitekturën e pajisjes, a ka mundësi ndonjë ekspert që ta bëjë këtë lloj ekspertize që kërkon pala?

Z. D. Alimemeti: Arkitektura do t'u vihet në dispozicion, pra si është ndërtuar sistemi do t'u vihet në dispozicion. *Source* kodi, duke qenë se është pronë e kompanisë, nuk vihet në dispozicion, por mund të bëhet fare mirë vlerësimi në bazë të logove që ka pajisja. Çdo pajisje elektronike lë gjurmë për çdo veprim që është bërë. Kjo mund të jetë një mënyrë auditimi dhe është mënyra më e përhapur e auditimit. Mbase kësaj i referohet zotëria kur thotë për pjesën e auditit. Ekziston mundësia edhe nëqoftëse...

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. F. Nuri: E kemi kërkuar nëse mundet të loget. Është pika e fundit logs dhe aktiviteteve...

Z. L. Braho: Tani, ju kërkon logimin në ditën e zgjedhjeve apo kërkon testim të logimeve që duhet të bëhen?

Z. F. Nuri: Kërkesa ka qenë e tillë: Kërkojmë logs të aktiviteteve të çdo gjëje që ka ndodhur në sistem, veçanërisht tek time terms dhe tek paterna mes tyre. Pra, është teknike nuk është se e kemi formuluar ne, ka ardhur nga ekspertë domethënë edhe kjo, vetkuptohet.

Z. I. Rusmali: Keni ekspert?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Po, gjej ekspert!

Z. I. Rusmali: Pse nuk e kërkon aksesin?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: E kemi kërkuar, me shkrim.

Z. I. Rusmali: Eksperti juaj ti marrë dhe ti vizitojë ai ato loget dhe...

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: E kemi kërkuar dhe ripërsëritur disa herë edhe me audio edhe me shkrim edhe me çdo gjë tjetër!

Z. L. Braho: Tani ti kërkon ti kqyrësh të gjitha pajisjet e Kamzës apo për provë, me short, disa prej tyre?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Atëherë meqënëse unë jam pala ankuese dhe që kam edhe barrën e provës si të themi, për të provuar para jush, unë kërkoj të përzgjedh dhjetë qendra dhe nga këto dhjetë qendra ushtroj auditimin nga inxhinier IT-je edhe ai i njohur absolutisht, i certifikuar...

Z. L. Braho: Përgjigjen e kësaj pyetjes mund të na e jepni të dy bashkarisht, sa kohë duhet për këtë procesin? Për 10 qendra i bie 20 pajisje, është një proces që merr kohë apo...?

Znj. D. Alimehmeti: E para njëherë, duhet të diskutojmë me kompaninë dhe e dyta, procesi marrjes së logeve që do të merret nga çdo pajisje do të dojë pak kohë.

Z. I. Rusmali: Sa?

Znj. D. Alimemeti: Le të themi një katër ditësh.

Z. K. Bele: Më falni se më duket se këto janë disa rrugë që nuk e di, nuk them që s'të dërgojnë asgjëkundi por nuk dimë, si hyet edhe nga dilet! Megjithatë ky është konstatimi im, është personal. Ju thoni kemi një ekspert, çfarë nënkuptoni? Një ekspert IT-je apo një ekspert që është marrë me zgjedhjet elektronike? Sepse për fat të keq, ose ndoshta nuk është fat i keq por është çështje fakti, nuk është se zgjedhjet elektronike kanë eksperiencë të gjatë në këtë vend. Si çdo gjë që vjen për herë të parë mund të ketë edhe probleme me ekspertizën, këtë dua, në këtë dritë e bëj pyetjen. Pra një IT që pretendon e shikon atë makinën dhe thotë është në rregull apo nuk është në rregull, nuk e dimë ku do na çojë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Atëherë, unë kam komunikuar me ekspertë paraprakisht sepse absolutisht që në dy rezultatet e para që më ka dalë në kamer, për shkak dhe të profesionit që kam kaluar, unë e kam kuptuar që ky është një krim kibernetik. Po, po që atë natë! I ke pamjet tek shtabi im! Në tri faturat e para...

Z. L. Braho: Më fal, mos të bëjmë akuza publike pa bërë auditimin.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Është qëndrimi im! Është dyshim! Nuk po fajësoj njeri ose kush e ka bërë, të paktën të tillë perceptim kisha unë, një dyshim i arsyeshëm. Sepse nuk ndodh që të kem rënie në çdo qendër votimi dhe nuk ka ndodh në asnjë palë zgjedhje.

Z. I. Rusmali: Nuk mund ta gjejmë në tre faturat e para.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Në tre faturat e para e gjej sepse unë kërkova faturat kur i dija votat pak a shumë në rezultat në vijimësi.

Z. I. Rusmali: Mos hiperbolizojmë.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: S'po hiperbolizoj fare, unë po them çfarë ka ndodhur dhe pse kam dyshuar që në fillim.

Z. I. Rusmali: Ju keni një nevojë. Nuk e bën KAS-i, KAS-i nuk meret me prova, nuk grumbullojmë ne prova. Ne ju ndihmojmë që ju të merrni provat. Keni këtë nevojë sepse keni një pretendim, puna është që nevojën që ju keni, më të rëndësishme ju e lini gjithmonë si më të parëndësishme. Pala tjetër sigurisht që nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

ka ndonjë vëmendje të posaçme për këtë nevojë dhe shkojnë 15 ditë nga afati që ne duhet të kishim dhënë vendimin dhe vazhdojmë dhe kërkojmë tani dhe katër ditë, pesë ditë, kohë. Nuk është luks që ne e disponojmë, sepse ne jemi të kufizuar nga ligji, ky është diskutimi që kemi. A mund t'i pajtojmë dy gjëra që janë kaq larg njëra tjetrës? Kërkesën tuaj me afatin e kaluar, e harxhuar kot? Me afatin e harxhuar kot?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Kërkesa ime është në datën 25.05.2023 me numër protokolli 5457, nuk është kërkesë e re por është kërkesë e bërë që në fazën e ankimit.

Z. I. Rusmali: Jo, të lutem, mos të abuzojmë. Kërkesa jote është kërkesë drejtuar KAS-it, që KAS-i të caktojë një ekspert ndërkombëtar, ta paguajmë ne nga xhepi jonë që të bëj ty detyrën.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Jo!

Z. I. Rusmali: Kërkesa jote nuk është më jepni aksesin tek makinat që ekspertët e mi të bëjnë verifikimin e makinave. Nuk ka qenë kështu asnjëherë, madje edhe tani doli me zor, nuk doli siç duhej. Tani doli për shkak të insistimit të kolegëve.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Jo, nuk them gjëra me zorr unë them gjëra që bindem vetë dhe kërkesa ime më parë ka qenë caktimi... nuk e kemi përcaktuar dhe nuk e kemi diskutuar, absolutisht jo dhe unë e kam thënë edhe me audio, po ta hapni, që absolutisht jemi në gjendje që të sjellim ekspert.

Z. I. Rusmali: Ekspertë ndërkombëtarë se e kemi me letra.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Po me letra po them edhe unë. Që nga ankimi...

Z. F. Nuri: Kërkesa është drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me datë 25.05..

Z. E. Lako: Zoti Hoxha, kur kërkon një provë, e kërkon një provë. Kur e ke një provë, qoftë e njëanëshme duhet ta dorëzosh atë provë.

Z. I. Rusmali: Të bëj një ndërhyrje! Ule letrën, të ngre unë këtë letrën time, kjo është kërkesa juaj ankimore drejtuar tek ne.

Z. F. Nuri: Nuk po flisja për atë!

Z. I. Rusmali: Unë po flas për këtë! Sepse ne na keni drejtuar këtë kërkesë dhe në këtë kërkesë na kërkonin ne që t'ju caktojmë ekspertë ndërkombëtarë. Tani, gënjeva unë?

Z. F. Nuri: Jo nuk po kundërshtoj atë po them këtë tjetrën.

Z. I. Rusmali: Më thuaj, unë gënjeva apo jo?

Z. F. Nuri: Jo, nuk keni gënjyer për atë.

Z. I. Rusmali: Unë nuk kam gënjyer!

Z. F. Nuri: Jo, kush e tha atë?!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. I. Rusmali: Thashë nëqoftëse nuk do të ishte kjo kërkesë, por do të ishte kërkesa drejtuar Komisionit që na vini në dispozicion një specimen makinash që ne të bëjmë provën tonë, që të mbështesim pretendimin tonë, do të kishit KAS-in me pesë vota në mbështetjen tuaj, ditën e parë që u paraqitët tek ne. Keni kërkuar nga ne ekspertin ndërkombëtarë, nuk keni kërkuar... këtë e kërkonti tani mbas 13 ditësh. Kaq thashë unë! Ju kërkoj ndjesë nëqoftëse ju kam prekur sentimentet e tuaja. Kaq thashë vetëm!

Z. F. Nuri: Dhe ne i nderuar nuk thamë se ka gënjyer njeri. Në datën 23 ju kemi të depozituar kërkesën ankimore, patjetër nuk po e kundërshton njeri atë. Thjesht saktësimi!

Z. I. Rusmali: Po i ikën çështjes!

Z. F. Nuri: Nuk po i iki aspak. Këto terma teknik, për termat teknik i nderuar, kandidati i ka kërkuar në datën 25 dhe i janë drejtuar KQZ-së. Pra paterna, autentifikimi dhe autorizimi etj etj... Është bërë edhe kërkesa për të testuar manualisht sistemin etj etj..., janë bërë logset që sapo i thamë pak më parë. Janë bërë në datë 25 drejtuar zotit Celibashi.

Z. E. Lako: Tani përsa i përket ankimit në KAS, ju keni kërkuar një ekspert ndërkombëtar, të cilën ne nuk... nëqoftëse i qëndroni kësaj kërkesës ne do të marrim vendim për këtë kërkesën tuaj dhe e zgjidhim këtu këtë punë. Nëse ju keni ekspertët tuaj dhe keni ndonjë raport që i shërben procesit ishit të mirpritur që këtë raport ta dorëzonin në cilësinë e provës, provë e njëanëshme e juaja për pretendimet që keni. Në lidhje me pretendimet që është bërë një krim kibernetik, nuk është ky vendi dhe nuk mundet që ne të marrim një ekspert për të provuar një “krim” që i takon një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

organi tjetër. Ky është ai sqarimi që po vazhdojmë të bëjmë. Ndërsa për garancitë që ka dhënë Kodi për sistemin elektronik që pavarësisht se po përpigemi që të gjejmë ndonjë të metë janë ato që ne i kemi evidentuar këtu përpara të gjithëve nëpërmjet provës fizike, të votës fizike me atë elektronike, që në të gjitha rastet që është bërë ky krahasim ato kanë përkuar 100%. Kështu që kjo është garancia që ka dhënë ligji dhe që kanë rënë dakod të gjithë palët në momentin e caktimit të këtij lloj votimi në projektet pilot sot dhe mbase nesër në të ardhmen dhe më shumë, pak a shumë. Kështu që nëse ju vazhdoni të kërkoni që ne të marrim një ekspert ndërkombëtar për një gjë që na takon apo jo, ne mund të tërhiqemi të marrim një vendim dhe të vazhdojmë. Nëse ju doni të kishit një ekspert tuajin mund ta kishit, mund ta kishit bërë, mund ta kishit dorëzuar, që ta ndajmë këtë pjesë.

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Atëherë, përpara se të kisha një ekspert, unë duhet të kisha përgjigjen e atyre pyetjeve. 70-80% të punës eksperti e bën me anë të paraqitjes dhe dokumenteve që ne kemi kërkuar. Absolutisht jemi në gjendje që të sjellim një ekspert, i cili është i certifikuar, dhe e sjellim me shpenzimet tona. Por, ne na duhet së pari, dokumentacioni që kemi kërkuar, sepse eksperti pa dokumentacion nuk mund të vijë dhe absolutisht është i parëndësishëm, pjesëmarrja e tij në proces, ndërkohë që paraprakisht nuk është i njohur me dokumentacionin e pajisjeve që janë implementuar dhe të atyre kërkesave që janë bërë në mënyrë, duke u komunikuar paraprakisht me ta. Faleminderit.

Z. E. Lako: Ka pala e interesuar ndonjë prapësim në lidhje me këtë?

Z. M. Legisi, përfaqësuesi i PS: Po, ne duke parë le të themi, sasinë edhe cilësinë e kërkesave të palës ankimuese mbi administrimin apo mbi hetimin e arkitekturës së

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

procesit të votimit elektronik etj. etj, na bën të mendojmë, që këto janë kërkesa që i shkojnë për shtat një subjekti që është komplet kundër votimit elektronik. Mirëpo Rregullatori e ka miratuar këtë projekt-pilot, dhe nuk ka pasur ankim ne dijeninë tonë. Tani projekti, prandaj është pilot, për të evidentuar....., nuk aplikohet në të gjithë sistemin, por aplikohet në një zonë të caktuar që në rastin konkret ka qenë: Elbasani, Vora, dhe Kamza. Rastin e Elbasanit e verifikuam, se si dolën pretendimet, pra dhe nga rinumërimi. Në këtë kontekst, duke parë edhe diferencën e madhe prej 11.592 (njëmbëdhjete mijë e pesëqind e nëntëdhjete e dy) votash dhe faktin që nuk është ankimuar fare, vendimi i Komisionit Rregullator për aplikimin e këtij projekti, ne vlerësojmë që këto janë pretendime që vetëm e tejzgjasin këtë. Pra, nuk është se ne jemi kundër hetimit, por për shkak dhe të vonesave të kërkesave në këtë proces sikurse u konstatuan, ne e vlerësojmë që nuk....

Z. E. Lako: E qartë, faleminderit! Ka ndonjë pyetje tjetër nga kolegët? Atëherë në këtë fazë, pala ankuese edhe një herë, keni ndonjë kërkesë tjetër, që ne duhet të shprehemi para se të mbyllim hetimin. Pra, i qëndroni kërkesës që kërkon nga KAS, që ta saktësojmë këtë? Të marrim një ekspert ndërkombëtar? Dhe për çfarë? Apo ju keni kërkesë, që ju duhet të kishit marrë një ekspert për të paraqitur një provë, që mund ta kishit bërë. Cila është kërkesa që ta ...?

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Kërkesa ka qenë e qartë që në fillim: që kërkojmë asistencën apo praninë e një eksperti të pavarur, mundësisht e kemi shprehur, mundësisht ndërkombëtar, në dijeninë time, që të jem korrekt me atë, çfarë kemi kërkuar. Në rast se kjo, nuk mund të përmbushej nga ana e KQZ-së, apo e KAS-it, atëherë kjo, mund të realizohet nga ana e..., mund të marr përsipër unë si kandidat dhe stafi im, mund të marr përsipër asistencën e një eksperti të tillë, i njohur

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

ndërkombëtarisht, në këtë fushë. Kërkesat e tjera, sepse unë siç e thashë edhe më lart, nuk është plotësuar asnjëra deri më tani nga kërkesat tona, për të pasur pastaj që të dilnim edhe ne, në konkluzionin përfundimtare. Prandaj kërkojmë që të na vihet në dispozicion të gjitha materialet që nuk përbëjnë ndoshta të dhëna konfidenciale, të cilat nuk mund t'i vihen në dispozicion palëve në një proces administrativ, dhe pas kësaj rezervojmë të drejtën në një afat të caktuar dhe të mundshëm, objektiv, për t'u realizuar këto nga ana jonë, ne t'ju vëmë në dispozicion, apo të vijmë me konkluzione përfundimtare, ku shprehim të gjitha pretendimet tona, apo prapësimet tona në lidhje me procesin, të cilin ne e kemi iniciuar. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit. Pala e interesuar ishit kundër kësaj, apo jo?


Z. M. Legisi, përfaqësuesi i PS: Ne e dhamë shpjegimin tonë. Sa i përket pyetjes për t'u marre apo jo, ne e lëmë në çmim të Komisionit, nuk është se...

Z. E. Lako: Zoti Merkaj, keni gjë në lidhje me këtë kërkesë për të thënë?

Z. Y. Merkaj: më së pari këtë e vendos KAS-i

Z. E. Lako: Atëherë KAS-i do të tërhiqet për vendim në lidhje me këtë kërkesë dhe besoj për 5-10 minuta do t'ju thërrasim përsëri.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Rifillon seanca

Ora 14:00

Z. E. Lako: Mirë e riçelim përsëri seancën e këtij shqyrtimi administrativ. Atëherë KAS, pasi u konsultua, vendosi që ta rrezojë kërkesën e palës për marrjen e një eksperti të huaj ndërkombëtar, pasi vlerëson se, në këtë procedim administrativ, nuk mund të ..., marrja e këtij eksperti nuk ka ndonjë vlerë në këtë proces, pasi dhe ajo çfarë u pretendua, nuk mund provohet nëpërmjet kësaj prove që kërkon të merret, pra nga ekspertimi i logeve, dhe ajo që u diskutua këtu. Pra, kjo nuk na çon..., kjo provë që kërkon të merret, nuk na çon në pretendimin për ndryshim të rezultatit nga makineritë që mund t'i përkasin një procesi tjetër, nga ky proces administrativ që jemi ne duke shqyrtuar. Ne, me këtë rast, gjithsesi e inkurajojmë KQZ-në, që të bëjë të gjitha provat e nevojshme me pjesëmarrjen e palëve për të rikthyer besimin e tyre, në procesin e votimit elektronik. Atëherë, me përfundimin e kësaj kërkesë që u rrëzua nga ana e KAS-i, dhe kundër këtij vendimi, ju mund të bëni ankim me vendimin përfundimtar. Keni ndonjë kërkesë tjetër? Po, zoti Nuri.

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Po, faleminderit zoti relator. Ne kemi edhe një kërkesë tjetër, që ka të bëjë me një vendimmarrje të Komisionit Rregullator. Bëhet fjalë për vendimin “Për llojet dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe të numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhjet e Republikës së Shqipërisë”, të datës 13.11.2020. Në vlerësimin tonë kemi këtu një pikë, në pikën 10, germa “k”, parashikohet në lidhje me votimin elektronik, se “Votuesit duhet t'i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë, përfshirë dhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

votës, si dhe kutia të mundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës”. Pyetja që ne kemi përderisa këtu, po flasim dhe për çështjen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, pyetja jonë qëndron: nëse është zbatuar ky vendim i Rregullatorit, në lidhje me pajisjet e votimit elektronik PEVN, në rastin e Kamzës? Pra, që të kishte mundësi zgjedhësi, ta kontrollonte fletën fizike të printuar, me atë që ai, i ka dhënë dakordësinë në versionin elektronik, përpara se ta konfirmonte votën. Faleminderit!

Z. E. Lako: Zoti Nuri në seancën e kaluar u bë një demonstrim, dhe ju ishit pjesë e demonstrimit, përveç faktit që përpara ditës së zgjedhjeve, keni pasur mundësinë që në demonstrimin që ka bërë KQZ-ja, të merrnin pjesë të gjithë palët në proces, megjithatë, nga administrata mund të kem...

Z. Y. Merkaj: Absolutisht po! I është dhënë mundësia të gjithë zgjedhësve që të kenë mundësinë të fotografimit e votës, së parjes së votës, në dritaren e printerit që është pjesë e pajisjes PEVN.

Z. E. Lako: Si dhe pjesa e konfirmimit.

Z. Y. Merkaj: Po, po, dhe konfirmimit. Personi fizik e ka parë, i është dhënë mundësia ta shikonte zgjedhësi, para se ta votonte.

Z. Y. Merkaj: Po, zoti Nuri

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Një sqarim të vogël. Po ne kemi bërë, po është e vërtetë zoti Lako që u vu pajisja e testimit herën e fundit, dhe pasi votoi një herë, bëhej zgjedhjen për kandidatin për kryetar konfirmohej, bëhej zgjedhja për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

kandidatin për këshill, konfirmohet, dhe pastaj jepej print, por nuk kishte konfirmim mbas printimit. Nëse pajisja e testit e kishte këtë veçori dhe nuk e kanë pasur pajisjet e tjera, ndoshta kjo është për t'u parë dhe pyetje për administratën. Por, unë e ripërsëris edhe një herë: pika 10, germa "k", e vendimit në fjalë të Rregullatorit e ka shumë të qartë: "...që zgjedhësit duhet t'i jepet mundësia që të konfirmojë pasi të këtë verifikuar versionin fizik të votës", ta konfirmojë në buton, se nuk ka si e konfirmon ndryshe. Dhe kjo, te testi në dijeninë time nuk ka qenë, tani po mbetet ndoshta administrata të na e sqarojë, në këto zgjedhje. Sepse ky vendim është i vitit 2020, është i 13 nëntorit 2020. Ndoshta për këto zgjedhje., si ka qenë çështja?

Z. E. Lako: Po, ju lutem.


Znj. D. Alimemeti: Është marrë vendimi i Rregullatorit, për procesin e votimit elektronik dhe kërkohet, ose le të themi është parashikuar konfirmimi i votës elektronike në të dyja rastet. Le të themi, kqyrja, duke qenë se kanë qenë të dyja proceset njëra pas tjetrës, kqyrja ose le të themi, evidentimi i votës letër, e asaj që printohet. Kjo është, çfarë është parashikuar në vendimin e Rregullatorit.

Z. E. Lako: Me ç'kuptova, pretendimi i ankuesit është që dhe printimi duhet të konfirmohet? Ky është pretendimi?

Z. K. Bele: Me falni, ajo që thatë ju, nqs u kuptua drejt, sipas jush duhet të dalë printimi përpara konfirmimit përfundimtar apo jo? Këtë po kërkoni ju?

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Unë nuk po kërkoj atë, i nderuar, unë po lexoj dhe po mundohem të interpretoj Rregullatorin, se çfarë ka dashur të thotë te pika 10. Po

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

e citoj dhe një herë, që ndoshta të jemi të qartë të gjithë: “Votuesit duhet t’i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë, përfshirë edhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës”, konfirmimin e verifikimit fizik të votës, “..si dhe kutia të mundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës”.

Z. K. Bele: Po pra, ti konfirmon me klikim për herë të dytë, që ai është vullneti yt, dhe në momentin që ti e konfirmon, ajo do të printohet.

Z. E. Lako: Konfirmimi i asaj që ju shprehet vullnetin, është vota fizike që del në ekran.

Z. K. Bele: E kundërta zoti Nuri, n.q.s ju kuptoj drejt, nëse juve ju dilte në print, ajo, dhe ju mund të ndërronit mendje, i bie që kutia do mbushej me letra pa fund, dhe ti nuk mund të bëje atë kontroll që bëre, që çdo votë është e numërueshme fizikisht. Pra ato janë..., mund t’i quajmë të njëkohshme, apo printimi vjen pas shfaqjes së vullnetit. Po e kundërta s’ka kuptim, se ne duhet të përdorim dhe “common sense-in”.

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Një pyetje për drejtoreshën. Si ka qenë praktika në zgjedhjet e kaluara? Pajisjet, a e mundësonin një konfirmim të tillë?

Znj. D. Alimemeti: Nuk e kam këtë informacion. Unë personalisht, duke qenë se kam ndjekur këto zgjedhje.

Z. L. Braho: Zoti Nuri dokumenti që po lexoni ju, çfarë dokumenti është? Çfarë vendimi i Rregullatorit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Ky i nderuar zoti anëtar i KAS-it, është vendimi “Për llojet dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe të numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhjet e Republikës së Shqipërisë”, i datës 13.11.2020.

Z. L. Braho: Pra është faza para prokurimit, pra prokurimi është marrë me këtë dokument, zoti Merkaj?


Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Mund t’ua vë në dispozicion dhe ju të gjeni rakordimin.

Z. E. Lako: Zoti Nuri...

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Kjo faktikisht ka të bëjë, se po e shof edhe brendinë, ka të bëjë me zgjedhjet e 2021-it. Vendosi: “Në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, procesi i votimit dhe numërimit të votave, ku do të zbatohen projekte pilot, të cilat duhet të përfshijnë jo më pak se 10% dhe jo më shumë se 20% të zgjedhësve, do të kryhet me anë të sistemit ose pajisjeve, sipas përcaktimeve të këtij vendimi”. Besoj jemi të qartë, vendimi ka qenë për 2021-in, thotë që zgjedhjet do të bëhen me këto lloj pajise. Nëse vendimi ka mendime, apo për këtë, unë nuk jam në dijeni, prandaj edhe për efekt transparence, jam i gatshëm t’ua vë në dispozicion.

Z. E. Lako: Zoti Nuri, me këtë pretendim, çfarë kërkoni? Ku doni të dilni? Cila është ... ? Sepse të gjitha proceset e verifikimit të votimit elektronik nga KQZ-ja, në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

dijeninë time dhe të KAS-it, dhe çfarë është diskutuar këtu janë ndjekur, vendimet e Rregullatorit janë zbatuar, ka pasur një proces, ku janë ftuar të gjitha palët për të bërë verifikimin, dhe mënyra se si funksionojnë pajisjet, dhe nuk besoj se ka pasur ndonjë pretendim. Dmth, cili është pretendimi juaj në këtë fazë, që ka lidhje me këtë çështje që po gjykojmë?

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Po faleminderit zoti Lako. Pretendimi ynë është logjik. Ne duam të kuptojmë nëse janë zbatuar të gjitha kërkesat e Rregullatorit, në lidhje me këto zgjedhje, me votimin elektronik. Dhe nëse në rastet e kaluara janë zbatuar, në këtë rast nuk janë zbatuar të njëjtat standarde, pse kjo “discrepancy” nëse ka pasur pra, diferencë. Pse në zgjedhjet e 2021-it, ka qenë diçka, dhe tani mund të jetë diçka tjetër. Ne duam thjesht si puna, si rastet e tjera, duam të shohim nëse janë zbatuar pikë për pikë të gjitha kërkesat e Rregullatorit.

Z. E. Lako: Mirë, nga administrata ka ndonjë koment tjetër, në lidhje me këtë?

Z. Y. Merhaj: Kjo është e njëjta pajisje që është përdorur në 2021-in, thjesht është bërë dhe konfigurimi për transmetimin e të dhënave dhe kaq, asgjë tjetër. E njëjta pajisje është.

Z. E. Lako: Shtesa në këto zgjedhje, është vetëm transmetimi i të dhënave në mënyrë elektronike. Ndërsa, si pajisje, si proces është e njëjta pajisje. Nuk ka pasur ndonjë pretendim, apo ndonjë ...

Z. Y. Merhaj: Po, e njëjta. Po e njëjta pajisje. Absolutisht asnjë pretendim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Znj. D. Alimemeti: Ishte një element. Është bërë ndryshimi vetëm për pjesën e zgjedhjeve qendrore me zgjedhjet lokale. Kjo është përshtatja.

Z. E. Lako: Po patjetër se....Ke zoti Braho?

Z. L. Braho: Kam një pyetje për administratën. Me këtë shkronjën “k” të pikës 10, “Votuesit duhet t’i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë..” që e kuptoj elektronikisht, “... përfshirë edhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës”. Mos Komisioni Rregullator me konfirmim.. verifikimin e versionit fizik, ka dashur të thotë atë dritaren që ti e konfirmon me sy votën, apo konfirmim me buton? Pra, është ideja e konfirmimit me sy. Tani kam një pyetje unë, nqs siç ishte ai rasti i Elbasanit që një komisioner pretendonte se kishte votuar për X-in, por vota fizike kishte dalë për Y-in, në momentin e konfirmimit fizik të votës, ka ndonjë mundësi që votuesi të ngrejë pretendim në KQV, siç është rasti psh, që voton gabimisht në fletën e votimit, që ai të thotë kam votuar gabimisht. Me jepni një fletë tjetër. Këtu te konfirmimi fizik ka ndonjë mundësi që ai ta raportojë këtë dhe të rinisë procedura, nuk e di çfarë është parashikuar.

Znj. D. Alimemeti: Printimi është në fund, dhe mundësia është dhënë përpara për të bërë konfirmimet ose ndryshimet, do të thotë: i jepet mundësia që të zgjedhë në elektronikë, dhe në fund fare është rezultati i asaj që zgjedh, është printimi. Pra është si vota në kuti

Z. E. Lako: Zoti Rusmali.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. I. Rusmali: Dikur, kur diskutohej, dmth marrja e kësaj teknologjie dhe bëheshin demonstrime për parlamentin, për ekspertët, për publikun, e ku di unë, mbaj mend që thuhej që makina të ofron mundësinë, që jo vetëm të modifikosh, sa kohë që nuk e ke mbyllur procedurën, të modifikosh votën tënde, ta ndryshosh vullnetin tënd. Por të jep mundësinë që sa kohë që nuk ke konfirmuar printimin, të skartosh edhe printimin, ta heqësh printimin dhe të rinisësh procesin dhe të nxjerrësh një printim të ri. Është kjo, apo e kam gabim unë, nga memorja?

Znj. D. Alimemeti: Nuk di t'u them për proceset e kaluara, por në këtë proces...

Z. I. Rusmali: Unë nuk flas për proceset. Flas për një gjë që ka ndodhur më përpara. Kur demonstroheshin atëherë, avantazhet e teknologjisë, nuk e kam idenë se si është në proces gjëja, prandaj po pyes.

Znj. D. Alimemeti: Aktualisht, Procesi konfirmohet elektronikisht. Do të thotë jepet mundësia dhe nqs ka ndryshuar...

Z. I. Rusmali: Vetëm pyetja është: Atëherë thonin, e tregonin dhe si gjë të madhe, të jep mundësinë ta "skartosh" votën fizike, ta shënosh e gabuar dhe ta skartosh, dhe ta bësh nga e para, dhe ta nxjerrësh nga e para. Pra, të kthehesh edhe kur e ke printuar, të kthehesh mbrapsht, jo vetëm kur je në versionin elektronik.

Znj. D. Alimemeti: Kjo, në këtë proces nuk mundësohet, do të thotë nuk kthehet mbrapsht printimi. Jepet tërë mundësia e vlerësimit të votës ose e konfirmimit dhe ndryshimit të saj përpara, bëhen zgjedhjet, mund ta ndryshosh zgjedhjen, mund ta

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

konfirmosh, je i sigurt për zgjedhjen tënde, dhe në fund fare është komanda “printo”, printo të hedh në kuti, votën që ti ke zgjedhur.

Z. E. Lako: Mirë, besoj se pyetjet.... Po, zoti Nuri.

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Edhe një pyetje të fundit për administratën e KQZ-së, në lidhje pikërisht me këtë pikë. Në zgjedhjet e kaluara, a ka pasur të drejtë votuesi nëse bëhej pishman, apo ngatërronte votimin, që ta ndërronte fletën, dhe para se të printohej, në vazhdën edhe të asaj që tha zoti Rusmali. Ka pasur ... se ju thatë edhe për pjesën se mos dilnin fletët, mos bëhej ..., apo jo zoti Bele, mos bëhej printime dhe ngatërroheshin fletët. A mos ka pasur vallë fletë pa barkod ato që anuloheshin, dhe bien në kuti dhe i jepej e drejta që të printonte përsëri për herë të dytë votuesi?

Znj. D. Alimemeti: Në dijeninë time nuk lejohet pa barkod. Do të thotë barkodi të lidh votën me makinën që ka printuar.

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Pra, anulohet, jo se do të themi.. kur ai nuk e konfirmonte, votuesi.

Znj. D. Alimemeti: Në të tëra rastet duhet të lidhte me makinën

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Po, patjetër me makinën. Pyetja ishte...
(Nga salla flitet pa mikrofon dhe njëkohësisht)

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Po patjetër, ajo në versionin elektronik kthehet. Jo ishte më tepër për konfirmimin fizik. Pra, në rast se ishte bërë pishman, po e riformuloj, personi, ose ka ndërruar mendje dhe nuk e konfirmon më atë që është printuar, do ta anulojë po themi, fleta e votimit në atë rast binte, në zgjedhjet e kaluara, nuk po flas për këto zgjedhje, binte pa barkod apo me barkod?

Z. Y. Merkaç: Jo pra, nuk bie me barkod, se është njësoj si votimi me fletë. E merr fletën, në qoftë se fletën e hedh në kuti, nuk voton dot më. E ke bërë zgjedhjen tënde.

Z. K. Bele: Më fal më duket sikur jemi kthyer 4 vjet para dhe po diskutojmë avantazhet dhe disavantazhet e votimit elektronik. Thjesht për një Ne jemi në një proces administrativ që ka të bëjë me pavlefshmërinë në një zonë të caktuar. Debati pro dhe kundër votimit elektronik është i gjatë në të gjithë botën. Ka vende e kanë futur, ka vende që s'e kanë futur, ka vende që e kanë futur, e kanë hequr, ky debati vlen a posteriori të gjithë kësaj, mirëpo ne këtu mund të ngelim pa fund të marrin dhe ca manuale të diskutojmë mund të ishte bërë më mirë mund të ishte bërë më keq. Çështja është kemi në një zonë të caktuar zgjedhore, kemi një rezultat të caktuar, kemi paraqitur prova dhe duhet të arrijmë në një konkluzion në disa kërkime finale. Pyetjet janë të pafundme, koha jonë dhe mjetet ligjore për të përfunduar procedurën është e fundme. Kështu që me gjithë vullnetin tonë të mirë për të adresuar ato që ju keni për të parashtruar.

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Ju kuptova drejt, përtej, në lidhje me atë që sapo thatë, ne nuk besoj se jemi këtu për të kontestuar, apo për të bërë gjyqin e votimit elektronik në tërësi. Pyetja që ne ngritëm, ose më tepër kërkesa procedurale që ne

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

ngritëm në këtë rast, ishte për të vërtetuar, dhe për të provuar, ose për të parë nëse ishin zbatuar të gjitha kërkesat e Rregullatorit. Nuk ishte për.. Kjo ishte çdo gjë.

Z. E. Lako: Mirë, atëherë nëse mendojmë që i kemi ezauruar, kalojmë në pretendimet përfundimtare. Do ta filloni ju zoti Nuri, apo zoti Hoxha në lidhje me ankuesin.

Ju lutem shkurtimisht se këtu do jemi edhe për rastin e bashkisë tjetër, të Belshit!

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Shkurtimisht se këtu do jemi edhe për rastin e bashkisë tjetër, të Belshit. Atëherë në lidhje me zonën e Kàmzës, besoj se për aq pak kohë sa na u la në dispozicion, dhe për aq pak materiale filmike, arritëm të sjellim prova të mjaftueshme për abuzime dhe për shkelje të mëdha gjatë procesit zgjedhor, shkelje të Kodit Zgjedhor nga operatorët, nga vëzhguesit, prezenca që ishte jo... distanca nuk ishte 1 metër e gjysmë larg operatorit por ishte mbi aparaturat, duke manipuluar, pra, duke prekur ekranet, herë pas here, në pretendimet për asistimin e personave që kishin të drejtë të votonin. Nuk kemi parë dhe nuk kemi venë re, që të ketë në librat e protokollit, të ketë shënime në lidhje me autorizime të posaçme, që shoqërues të caktuar të kenë shoqëruar, të kenë marrë të drejtën, për të shoqëruar persona për të votuar. Kemi konstatuar shkelje të rënda të Kodit Zgjedhor në lidhje me personat në pamundësi fizike për të votuar, e gjithanshme kjo, mjafton që personi të ishte në një moshë të caktuar relativisht po themi mbi 50 vjeç, dhe menjëherë shkon operatori apo dikush tjetër nga komisioni me pretendimin se do t'i asistonte, thyente të gjitha rregullat dhe procedurat që vetë KQZ-ja ka miratuar. Kemi venë re votim familjar, që do të thotë 2 ose 3 veta mbrapa ekranit të kompjuterit elektronik të votimit, kemi konstatuar prezencë sikundër e tha dhe kandidati të administratës në komisione, brenda komisioneve, me telefon në dorë, duke bërë çdo gjë, përveç

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

duke bërë respektuar ligjin. Për mori shkeljesh të tilla, ne gjykojmë se jemi përpara shkeljeve mjaft të rënda të procesit zgjedhor, konkretisht të shkeljes të së drejtës kushtetuese, të votës së lirë, të sekretit të votës, të votës individuale, ku nuk voton vetë personi, por voton dikush tjetër, sikundër e ka përmendur edhe Gjykata Kushtetuese në raste të mëparshme. Janë shkelje të tilla që e tjetërsojnë procesin dhe automatikisht duhet të shpallet pavlefshmëria e këtyre zgjedhjeve. Ndaj unë do kërkoja përfundimisht shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve të rezultatit për Bashkinë Kamëz, dhe ripërsëritjen e zgjedhjeve. Po ia lë fjalën kandidatit për të thënë dhe ai konsideratat e tij. Faleminderit!

Z. A. Hoxha, kandidat i BF: Faleminderit! Të nderuar anëtarë të komisionit KAS, gjatë këtyre seancave ne kemi arritur, me bindjen time, me prova të pakundërshtueshme, që në ato qendra votimi që na u dha “akses” të bënim kqyrjet e pamjeve filmike, që më datën 14 Maj, ka patur shkelje, të cilat, konkludojnë me operatorët që votojnë hapur në qendrën e votimit; konkludojnë në pjesëmarrje në votime pa autorizime përkatëse siç e kërkon, pa deklaratë përkatëse, para komisionit të qendrës së votimit, siç e kërkojnë edhe procedurat standarde në ato raste. Mbi 50% apo 60% e disa qendrave të votimit votojnë qytetarët, votuesi është i shoqëruar, pra nuk është votimi individual, pra nuk shpreh vullnetin e tij të lirë më datën 14 Maj. Kemi konkluduar që ai votim nuk ka patur fshehtësi, kemi konkluduar që në atë votim, administrata e bashkisë dhe drejtuesit e Bashkisë së Kamzës, por edhe të pushtetit qendror, kanë intimiduar, kanë kontrolluar, gjatë gjithë ditës, procedurat dhe votuesin nga momenti i hyrjes në qendrën e votimit deri në shprehjen e vullnetit të tij, në votën e tij edhe në dalje. Pa as edhe një lloj autorizimi, për të qenë i pranishëm në qendrën e votimit, dhe në konflikt të hapur me detyrat dhe përgjegjësitë dhe ndalimet që parashikon Kodi Zgjedhor, që një punonjës i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

administratës publike nuk mund të jetë në këtë rast, pa autorizim përkatës, i pranishëm përveç rastit kur ai voton, apo ku kërkohet me deklaram konkret për të asistuar një votues tjetër. Është shkelur absolutisht vendimi i Rregullatorit nr. 4, siç u parashtrua më parë, siç është implementuar në zgjedhjet e vitit 2021. Shkelje të cilat, absolutisht sjellin pavlefshmërinë, në një masë të tillë që ndikojnë në pavlefshmërinë e zgjedhjeve e datës 14 maj në Bashkinë e Kamzës, duke mos përjashtuar dhe rezervuar të drejtën që të ankimojmë, absolutisht të ankimojmë pafundësinë e auditimit nga një ekspert i pavarur, në shkallët e tjera të këtij ankimimi që ne absolutisht për këtë pikë do të bëjmë. Në këto kushte kërkojmë shpalljen të pavlefshme dhe ripërsëritjen e zgjedhjeve në Bashkinë Kamëz, me fletë votimi tradicionale, siç edhe janë edhe praktikuar në të gjitha zgjedhjet që janë zhvilluar në Bashkinë e Kamzës. Unë kaq kisha, ju faleminderit që më dëgjuat.

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Hoxha. Për palën e interesuar!

Z. Altin Legisi, përfaqësuesi i PS: Faleminderit zoti kryetar. Nuk po e zgjasim duke qenë se ne kemi mbajtur qëndrim në seancën e kaluar në lidhje me pretendimet që pothuajse janë po ato. Duke pasur parasysh dhe hetimin administrativ që zhvilluat sot, dhe u dhatë përgjigje edhe një pjesë të kërkimeve në objektin e kërkimit të “Bashkë Fitojmë”. Duke pasur parasysh referencën e nenit 160 të Kodit Zgjedhor kushtet komentative që kërkon dispozita përkatëse, në raport me faktin e përsëritjes apo jo të zgjedhjeve, mendojmë që standardi që kërkon të sjelli përfaqësuesi i “Bashkë Fitojmë”, në lidhje me këtë kërkim të tij, në tërësi të kërkimeve objekt shqyrtimi administrativ nga ana juaj, nuk e arrijnë dot standardin e përputhshmërisë të këtyre elementeve, me qëllim të atillë, që të kundërshtohet vendimmarrja e mëhershme. Kështu që në këto rrethana, për sa kohë kemi bërë diskutime në seancën

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

e kaluar, gjatë së cilës, kemi sjellë dhe me shkrim, në formën e konkluzioneve, duke qenë se ishte caktuar nga ana juaj sot edhe mundësia për dhënien e këtyre konkluzioneve kërkojmë lënien në fuqi të vendimit nr. 536, të datës 20.05.2023, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet e organizuara në qeverisjen vendore të datës 14 Maj 2023”. Ju falenderoj.

Z. E. Lako: Faleminderit! Zoti Sekretar i Përgjithshëm keni ndonjë ...

Z. Y. Merkaç: Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj e në prova.

Z. E. Lako: Mirë faleminderit. Atëherë KAS do të tërhiqet për vendim dhe për shpalljen e tij do të lëmë ditën e nesërme në datë, 7 qershor, në orën 10:45. Me kaq e deklaroj të mbyllur seancën.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

**06.06.2023
Ora 14:40**

RENDI I DITËS


“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 76, me subjekt ankues Koalicionin Bashkë Fitojmë, me objekt ankimi kundërshtimin e vendimit numër 533 datë 18.05.2023, të KSHZ”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Të tjerë:** PS (Z. E. Salianji, Z. M. Legisi)
BF (Z. F. Nuri, Z. I. Kaso, Kandidati Z. B. Qypi)

Z. L. Braho: Përshëndetje të gjithëve! Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 76 me subjekt ankues koalicionin Bashkë Fitojmë, me objekt ankimi kundërshtimin e vendimit numër 533 datë 18.05.2023, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Në seancën e kaluar është vendosur ose më saktë është kërkuar nga dy anëtarë të KAS që të kqyren të gjithë fletët e votimit për kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Belsh, si fletët e vlefshme dhe të pavlefshme për çdo qendër votimi të kësaj bashkie. Sot janë ngritur gjashtë grupe numërimi për kqyrjen e këtyre fletëve të votimit dhe me sa shoh subjektet zgjedhore kanë paraqitur dhe vëzhgues të tyre. Të pranishëm sot në seancë janë përfaqësuesit e subjektit ankimues Koalicioni Bashkë Fitojmë.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. F. Nuri: Franci Nuri, prezent.

Z. I. Kaso: Ivi Kaso, prezent.

Z. B. Qypi: Bedri Qypi, prezent.

Z. L. Braho: Po, faleminderit. Po ashtu janë prezent përfaqësues të palës së interesuar Partia Socialiste e Shqipërise.

Z. M. Legisi: Avokat Mariglen Legisi dhe avokat Erdian Salianji.

Z. L. Braho: Faleminderit! Prezent është dhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe trupa e KAS-it tashmë është më katër anëtarë, është kuorumi, një nga katër anëtarët vjen për pak momente. Kështuqë nga ky moment, ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët përpara se të nisë procesi?

Z. I. Kaso: Jo, nuk kemi. Të nisë menjëherë!

Z. L. Braho: Dakord atëherë, të fillojë kqyrja e të gjithë kutive të votimit sipas rendit që përcaktohet edhe në Kodin Zgjedhor, duke filluar nga qendrat e votimit me numrin më të vogël deri në qendrat e votimit të fundit. Do i lutem vëzhguesve të mbajnë qetësi për çdo fletë që nuk bien dakord me vlerësimin e grupit të numërimit që janë pjesë e administratës së KQZ-së ti drejtohen KAS-it për vlerësimin e fletëve.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Qendrën e votimit 2582 janë 4 (katër) fletë votimit që nga grupi i numërimit janë konsideruar të pavlefshme, 3 (tri) prej tyre vijojnë të jenë të pavlefshme ndërkohë që një nga këto bëhet e vlefshme për kandidatin Arif Tafani.

Për qendrën e votimit 2560, 1 (një) votë ka qenë e vlefshme dhe mbetet e vlefshme.

Atëherë, në qendrën e votimit 2552 janë 7 (shtatë) vota që kanë qenë të vlefshme, mbeten të vlefshme. 1 (një) fletë votimi ka qenë e pavlefshme sepse mungon një vulë mbetet e pavlefshme me shumicë votash.

Qendra e votimit 2570, 2 (dy) vota kanë qenë të vlefshme, mbeten të vlefshme.

Qendra e votimit 2569, 1 (një) votë ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme. Qendra e votimit 2560, 1 (një) fletë votimi ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme.

Qendra e votimit 2569, 1 (një) fletë votimi ka qenë vlefshme, mbetet e vlefshme.

Qendra e votimit 2570, 4 (katër) vota kanë qenë të pavlefshme, 2 (dy) prej tyre bëhen të vlefshme, 2 (dy) të tjerat rrinë të pavlefshme. Njëra me shumicë votash.

Në qendrën e votimit 2569, 1 (një) votë ka qenë e vlefshme mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2554, 3 (tri) vota kanë qenë të pavlefshme bëhen të vlefshme. 1 (një) prej tyre me shumicë votash.

Qendra e votimit 2571, 1 (një) votë që ka qenë e pavlefshme bëhet e vlefshme dhe 4 (katër) vota që kanë qenë të vlefshme mbeten të vlefshme. 3 (tri) prej tyre me shumicë votash që kanë gjysëm vule.

Z. E. Çefa: Administrata, ju lutem na sillni pak nje manual, nëqoftëse keni!

Z. L. Braho: Në qendrën e votimit 2560, 1 (një) fletë votimi ka qenë e pavlefshme, me shumicë votash mbetet e pavlefshme.

*Zbardhi materialin audio
Jonq DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Në qendrën e votimit 2565, 1 (një) fletë votimi ishte e vlefshme, mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2569, 1 (një) fletë votimi ishte e vlefshme, me shumicë votash mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2562, 3 (tri) vota që ishin të pavlefshme bëhen të vlefshme, me shumicë votash.

Në qendrën e votimit 2569, 1 (një) fletë votimi ishte e vlefshme, me shumicë votash mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2551, 6 (gjashtë) fletë votimi ishin të vlefshme, mbetet të vlefshme.

Në qendrën e votimit 2553/01, ishin 3 (tri) fletë votimi të pavlefshme, njëra mbetet e pavlefshme dhe dy të tjerat janë të vlefshme.

Në qendrën e votimit 2563, ishin 5 (pesë) fletë votimi të pavlefshme, 4 (katër) prej tyre bëhen të vlefshme, njëra mbetet e pavlefshme me shumicë votash.

Në qendrën e votimit 2562, janë 11 (njëmbëdhjetë) fletë votimi që kanë qenë të vlefshme, të gjitha mbeten të vlefshme por 10 (dhjetë) prej tyre me shumicë votash.

Në qendrën e votimit 2551, 4 (katër) fletë votimi kanë qenë të vlefshme, me shumicë votash mbetet të vlefshme.

Në qendrën e votimit 2586, 5 (pesë) fletë votimi të pavlefshme, njëra mbetet e pavlefshme, 4 (katër) ndahen dy nga dy si të vlefshme me shumicë votash.

Në qendrën e votimit 2555, 2 (dy) fletë votimi kanë qenë të pavlefshme, njëra bëhet e vlefshme për kandidatin Bedri Qypi.

4 (katër) fletë votimit në qendrën e votimit 2572 kanë qenë të vlefshme, me shumicë votash mbeten të vlefshme.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Në qendrën e votimit 2587, 2 (dy) vota që ishin të pavlefshme, bëhen të vlefshme për kandidatët respektiv.

Në qendrën e votimit 2555, 1 (një) fletë votimi ishte e vlefshme, mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2574, 2 (dy) vota kanë qenë të vlefshme, mbeten të vlefshme.

Në qendrën e votimit 2572, 4 (katër) fletë votimi kanë qenë të pavlefshme dhe të katërta bëhen të vlefshme. Njëra prej tyre me shumicë votash.

4 (katër) vota kanë qenë të vlefshme në qendrën e votimit 2564, mbeten të vlefshme me shumicë votash.

Në qendrën e votimit 2565, 1 (një) votë ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2565, 4 (katër) fletë votimi me një vulë nga pas, të gjitha për një kandidat, kanë qenë të pavlefshme, me shumicë votash mbeten të pavlefshme.

Në qendrën e votimit 2580, 1 (një) fletë votimi ka qenë e pavlefshme, mbetet e pavlefshme.

Z. K. Bele: Atëherë, në qendrën e votimit 2564, janë 2 (dy) vota të cilat kanë qenë të pavlefshme, KAS me shumicë votash i quan të vlefshme.

Në qendrën e votimit 2573, janë 3 (tri) vota nga të cilat të treja të konsideruara të pavlefshme, 2 (dy) prej tyre konsiderohen të vlefshme dhe njera ngelet e pavlefshme. Pra, kjo ngelet e pavlefshme dhe këto të dyja të vlefshme.

Z. L. Braho: Në qendrën e votimit 2573, 1 (një) fletë votimi ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2580, 1 (një) fletë votimi ishte e vlefshme mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2552/01, kanë qenë 2 (dy) fletë votimi të pavlefshme, njëra mbetet e pavlefshme tjetra bëhet e vlefshme.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Në qendrën e votimit 2580, 1 (një) fletë votimi me një vulë, ka qenë e vlefshme bëhet e pavlefshme me shumicë votash.

Në qendrën e votimit 2576, 1 (një) fletë votimi ka qenë e vlefshme mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2567, 2 (dy) fletë votimi kanë qenë të pavlefshme bëhen të vlefshme.

Në qendrën e votimit 2585, kanë qenë 3 (tri) vota të pavlefshme, njëra mbetet e pavlefshme, 2 (dy) bëhen të vlefshme. Njëra prej të cilave më shumicë votash.

Në qendrën e votimit 2561/01, 1 (një) fletë votimi ka qenë e pavlefshme bëhet e vlefshme.

Edhe në qendrën e votimit 2553, 1 (një) fletë votimi në këtë qendër ka qenë e vlefshme mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2556, janë 2 (dy) fletë votimi kanë qenë të vlefshme mbeten të vlefshme.

Në qendrën e votimit 2566, ka qenë 1 (një) fletë votimi e vlefshme me shumicë votash mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2553, 1 (një) fletë votimi ishte e vlefshme, me shumicë votash mbetet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2583, 1 (një) fletë votimi ishte e pavlefshme, me shumicë votash bëhet e vlefshme.

Në qendrën e votimit 2559, ishin 3 (tri) fletë votimi të pavlefshme, 2 (dy) bëhen të vlefshme me shumicë votash, 1 (një) mbetet e pavlefshme po me shumicë votash.

Në qendrën e votimit 2566, ishin 2 (dy) vota të pavlefshme, njëra bëhet e vlefshme, tjetra rri e pavlefshme.

Në qendrën e votimit 2579, 1 (një) fletë votimi ishte e pavlefshme, mbetet e pavlefshme, me shumicë.

*Zbardhi materialin audio
Jonq DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. Y. Merkaj: Më falni zoti Rusmali, po hapet kutia me votat gabim. Është grupi i tretë i numërimit.

Z. L. Braho: QV 2579, 1 (një) fletë votimi ishte e vlefshme, me shumicë votash mbetet e vlefshme. Atëherë meqënëse procesi i rivlerësimit dhe rinumërimet mbaroj, deri sa të përgatiten tabelat dhe tabela përbledhëse, e pezullojmë këtë seancë për tu rimbledhur për të dhënë rezultatin e tabelave dhe konkluzionet përfundimtare nga palët. Kështu që i falenderoj të gjithë vëzhguesit për punën e palodhur dhe numëruesit patjetër që janë nga administrata e KQZ-së. E pezullojmë për disa minuta seancën për tu rikthyer me tabelat përmbledhëse.

Rifillon seanca

Ora 17:52

Z. L. Braho: Përshëndetje edhe njëherë, riçelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore numër 76 me subjekt ankues koalicionin Bashkë Fitojmë. Pas kqyrjes së të gjitha kutive të votimit, fletëve të vlefshme dhe të pavlefshme, për çdo qendër votimi për këtë bashki është miratuar ose më saktë do të miratohet me vendim të ndërmjetëm tabela përmbledhëse e rezultateve, për kandidatin për Kryetarin e Bashkisë Belsh, pas këtij procesi këtu në KAS. Më kokretisht janë fletë të vlefshme të gjetura në kuti 9079, vota të pavlefshme 186 dhe rezultati është 4564 vota për kandidatin Arif Tafani dhe 4515 vota për kandidatin Bedri Qypi. Kjo është tabela e re përbledhëse për këtë bashki. Tashmë në këto kushte, nuk e di nëse palët kanë prova të reja, në rast se nuk kanë prova të reja vijojmë me konkluzionet përfundimtare.

Zbardhi materialin audio

Jona DERVISHI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. I. Kaso: Jo nuk kemi prova të reja, përveç provave që janë administruar përpara se hetimi administrativ të thellohej në kqyrjen e votave, të vlefshme, të pavlefshme sipas kërkesës. Kështu që nëse pala tjetër nuk ka gjë, KAS-i mund të vazhdojë me procedurën, pra ti jap fund hetimit administrativ dhe të kalojmë në konkluzion.

Z. L. Braho: Ju zoti Legisi?

Z. M. Legisi: Nuk kemi as ne kështu që kalojmë në diskutim.

Z. L. Braho: Dakord atëhere, i japim fund hetimit administrativ dhe vijojmë me konkluzionet përfundimtare. Si fillim fjala për përfaqësuesin e ankuesit.

Z. I. Kaso: Faleminderit, zoti drejtues i seancës. Sipas kërkesës tonë për rinumërim dhe rivlerësim KAS-i e pa të arsyeshme që në kuadër të kqyrjes dhe të hetimit administrativ ta thellonte hetimin në këto fletë dhe kreu në transparencën e plotë ato çka kishte brenda kutisë. Panvarësisht se në hartimin e tabelave përfundimtare dhe në vlerësimin e votave përdori një standart për një pjesë të konsiderueshme të votave duke i vlerësuar të vlefshme me shumicë votash, një standart që në këndvështrimin tonë nuk reflekton atë ç'ka është kërkesa ligjore ose parashikimet e manualit, përse i përket vlerësimit të votave. Sigurisht ato vota duhet të ishin vlerësuar në mënyrë të ndryshme, pra për të prodhuar një rezultat të ndryshëm. Por gjithsesi ne erdhëm këtu për transparencë dhe kjo pjesë e kërkesës tutje pjesës së vlerësimit ose konsideratës që kemi ne për vlerësimin e votave, quhet e ezauruar. Ajo ç'ka KAS-i duhet, që krahas reflektimit të rezultatit që doli nga rivlerësimi dhe rinumërimi, të bëj në tabelën përfundimtare të rezultatit dhe për këtë zonë

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

zgjedhore është ti japi përgjigje shqetësimit që kemi ngritur ne për qendrën konkrete të JVP-së të “Kosovës”, Lushnjes, e cila ndodhet dhe i jep efektet në këtë bashki. Për shkak se problematika e kësaj JVP-je fillon që nga momenti i ngritjes së saj në mënyrë të paligjshme, pra në kundërshtim të hapur me dispozitë urdhëruese të Kodit Zgjedhor, praktikisht nenit 43 të tij. Ku jo vetëm propozimi për ngritjen e këtij institucioni të posaçëm nuk është bërë nga KZAZ-ja por përkundrazi kemi një rast përplasje flagrante midis dy qëndrimeve, atij të KZAZ-së i cili ka tagrin për të konfirmuar ose për ti shprehur KAS-it nevojën për ngritjen e një JVP-je të posaçme, e cila ka marrë vendim që kjo qendër nuk duhet të ngrihet, vendim unanim ky dhe kërkesës se kryetarit të bashkisë i cili njëkohësisht edhe kandidat në garë që i drejtohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me kërkesën për të ngritur një qendër të posaçme dhe e vlerësojmë që qendra është ngritur gjithsesi panvarësisht se me vendim të Komisionerit në shkelje të një dispozite urdheruese. Pyetja e dytë që duhet dhe qëndrimi që duhet të mbajë gjithashtu KAS-i në këtë çeshtje është ti jap përgjigje përfundimtare shqetësimit që kemi ngritur edhe në një çeshtje paraardhëse se si duhet të votojnë shtetasit të cilët vuajnë dënimet në institucionin e vuajtjes së dënimit penal. Për sa kohë nuk e kanë vendbanimin ose të paktën atë kuptimin që i jep nocionit të vendbanimit ligji zgjedhor dhe jo vetëm, por edhe dispozitat urdhëruese të Kodit Civil, sikundër edhe ato dispozitat të ligjit të gjendjes civile që parashikojnë një kohëqëndrim të caktuar në një JVP për të mundur ta quajmë vendbanim dhe më pas për ti dhënë të drejtën shtetasit që vuan dënimin të votojë në atë institucion. Pra është një çeshtje e cila nuk duhet lënë, vlerësojmë, në diskrecionin e kryetarëve të bashkive, nuk duhet lënë në diskrecionin e administratës së burgjeve, nuk duhet lënë në diskrecionin e zyrave të gjendjes civile që ta zbatojnë ligjin si e kuptojnë ata. Sepse praktika ka treguar se secili e zbaton ligjin në mënyrën e vet si e kupton vetë por

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

krejt rastësisht ashtu si i konvenon forcës politike që është në pushtet dhe nga e cila varet si administrata e burgjeve dhe e gjendjes civile. Për të krijuar një standart të paktën përse i përket zgjedhjeve vendore që mbartin dhe problematikën më të madhe duhet që KAS-i të mbajë qëndrim dhe minimalisht ta konsiderojë të pavlefshëm procesin në të gjithë këtë qendër votimi panvarësisht nga sa mund të ndikojnë numrat në tabelën përmbledhëse të rezultatit. Duke shpallur në këtë mënyrë pavlefshmërinë e zgjedhjeve të procesit në këtë qendër votimi dhe më pas në vlerësim të diferencës të bëj urdhërimet përkatëse të përsëritjes ose jo. Kaq kisha përse i përket konkluzioneve, faleminderit.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Kaso! Fjala për përfaqësues dhe të palës së interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë.

Z. M. Legisi: Po, faleminderit. Përse i përket rezultatit dhe pretendimeve në lidhje me numrin e fletëve të votimit vlerësojmë që mori përgjigje pala ankuese me rivlerësim dhe rinumërimin e votave. Në lidhje me krijimin e qendrës së posaçme të votimit me numër 2565/1 ne vlerësojmë që vendimi i Komisionerit Shtetëror numër 501 datës 12.05.2023 dhe 24 vendime gjyqësore të administruara për efekt të ngritjes së kësaj qendre të posaçme votimi ne vlerësojmë që i mbyll dhe i vendosin kapak pretendimeve nëse kjo qendër duhet apo jo të numërohet. Kjo qendër duhet të numërohet dhe e drejta e votës është njohur me vendim gjyqësor dhe çdo pretendim tjetër për të mos u numëruar vota e tyre e fton KAS-in që të ndërhyjë në elementët e një vendimi gjyqësor dhe në vlerësimin tonë KAS-i nuk e ka këtë të drejtë ligjore për ta bërë. Në përfundim ne kërkojmë që të miratohet tabela sipas rinumërimit dhe rivlerësimit të votave të bërë në KAS. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Legisi. Atëherë, do të tërhiqemi për pak minuta për të shpallur vendimin, për pesë minuta besoj....

Rifillon seanca

Ora 18:10

Z. L. Braho: Atëherë, riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 76 me subjekt ankues koalicioni Bashkë Fitojmë. Pasi u tërhoqëm për vendim, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, mbështetur në nenin 21, shkronja b dhe nenin 143, pika 1, shkronja d të Kodit Zgjedhor, KAS me shumicë votash vendosi:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore numër 76 datë 22.05.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni Bashkë Fitojmë.
- Ndryshimin e vendimit numër 533 datë 18.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmblledhëse të rezultateve për zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë Belsh në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas tabelës përmblledhëse të miratuar me vendimin e ndërmjetëm të KAS të datës 06.06.2023.
- Rrëzimin e kërkesës për mospërfshirje në tabelën përmblledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të rezultatit të zgjedhjeve për qendrën e votimit numër 2565/1 JVP burgu “Kosova”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.06.2023*

Apelit, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 142 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më datë 6 qershor 2023. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 174

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

